



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / / OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI | 2017

INFORMATIV

Editorial:

Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore

Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Blerinda Idrizi, Udhëheqëse e projektit Forcimi Institucional i ABGJ dhe Mekanizmave Gjinor /Dada6 Niras

PËRMBAJTA

• INICIATIVAT E AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE

• Prezantohet Komentari i Ligjit për Barazi Gjinore	11
• Prezantohet dhe shpërndahet Komentari i Ligjit për Barazi Gjinore, në fakultetin Juridik	12
• Hartimi i kurikulës së trajnimeve për trajnerë, në fushën e barazisë gjinore	13
• ABGJ ka mbajt punëtorin për hartimin e koncept dokumentin për buxhetim gjinor	14
• Zbatimi i Buxhetimit të përgjegjshëm gjinorë	14
• Agjencia për Barazi Gjinore ka realizu vizitë studimore në Vienë, të Austrisë	15
• Përfaqësuesit e Institucioneve të Republikës së Kosovë të kryesuar nga ABGJ ishin në vizitë pune në Berlin të Gjermanisë	16
• Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar trajnimin “Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor dhe Analiza e Buxhetit”	16
• Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar Strategjinë për Komunikim, Avokim dhe Marrëdhënie me Publikun	17
• Studentët e Universitetit Veror u priten në takim nga Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e ABGJ	17
• Mbahet takimi i parë njoftues për Hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore	18
• Ka filluar punën grupi punues për hartimin e PKBGJ-së	18
• Zgjatet afati për Regjistrimin pa Pages të Pronës në Emër të dy Bashkëshortëve	19
• U mbajt takim pune me Donatorë, me fokus në Barazinë Gjinore	20
• ABGJ priti në takim Anëtarët e Korpusit të Paqës	20
• Mbahet takimi i grupit koordinues kundër dhunës në familje	21
• Miratohet Rregullorja për sistematizimin e brendshëm të Agjencisë për Barazi Gjinore	21
• Vlerësimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore	22
• Agjencia për Barazi Gjinore ka shënuar 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas	22

• AKTIVITETE AVOKUESE

• Mësimet e nxjerra/rekomandimet për PKBGJ e ardhshme	23
• Publikimi i hulumtimit: Gratë në mediat e shkruara 2014-2015”	24
• 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit	26
• Fushata promovuese /Ligji për Barazi Gjinore	27
• Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore	28
• Komunikatë për Media - Me rastin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11-të qershorit 2017	30
• Komunikatë për Media - Me rastin të Zgjedhjeve Lokale të 22-të tetorit 2017	31
• Komunikatë për Media ABGJ MAPL - Komunikatë për Media me rastin e konstituimit të organeve të Qeverisjes lokale	32

• BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET RELEVANTE

- ABGJ ishte pjesëmarrëse në takimin e gjashtë të organizuar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, Vilnius-Lituani 34
- Zyrtarë të ABGJ-së ishin pjesë e diskutimit publik “Qasja në drejtësi - Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë” 34
- Përfaqësues të ABGJ-së morën pjesë në konferencën regjionale “Matja e Barazisë Gjinore në Ballkanin Perëndimorë” 35
- Pjesëmarrje në Konferencën e Indeksit të Barazisë Gjinore, Bruksel 35
- Publikohet Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga 36
- Dhuna në Familje si dhe Plani i Veprimit 2016 -2020 36
- ABGJ mori pjesë në konferencën “Qasja në drejtësi dhe reparacione për të mbijetuarat e dhunës seksuale të lidhura me konfliktin” 37

• AKTIVITETET E ZYRTAREVE PËR BARAZI GJINORE NË MINISTRI DHE KOMUNA 38



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT// OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

Agjencia për Barazi Gjinore gjatë vitit 2017 ka realizuar një sërë veprimesh në drejtim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore në veçanti dhe legjislacionit që garanton barazinë gjinore në përgjithësi me synim të avancimit të pozitës së grave dhe vajzave në jetën publike dhe politike.



Një nga ndërmarrjet e suksesshme të ABGJ-së gjatë vitit 2017 është iniciimi i hartimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore – PKBGJ. Kjo politikë publike do të jetë vizioni kombëtar, me plan të veprimit për aktivitetet relevante për avancimin e parimeve të barazisë gjinore, përmbushjen e të drejtave të grave dhe arritjen e një shoqërie paqësore, të begatë dhe harmonike për gratë dhe burrat në Kosovë.

Dy ndërmarrje të rëndësishme të ABGJ janë: iniciativat për hartimin e koncept dokumentit për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinorë, dhe prezantimin e vlerësimit të ndikimit gjinorë si një nga instrumentet kyçe të domosdoshme në procesin e hartimit të koncept notave për propozimet e ardhshme për hartimin e projektligjeve apo strategjive, planeve të veprimit apo programeve kombëtare.

Gjatë vitit 2017 po ashtu kemi qenë të fokusuar në rritjen e qasjes së grave në pronë përmes promovimit të masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë, përmes organizmit të kampanjës informuese në nivel vendi, e cila solli rezultate pozitive ku deri në dhjetorë të 2017, 1197 çifte regjistruan pronën në emër të dy bashkëshortëve.

Ligji për Barazi Gjinore obligon institucionet e Kosovës të ndërmarrin hapa shtesë në lidhje me integrimin gjinor, buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Ligji i ri ka rishikuar të kuptuarit e barazisë gjinore dhe ky Ligj vendos pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe burrave në masën 50% , duke i bërë thirrje institucioneve që të marrin masa të përgjithshme dhe të veçanta në mënyrë që të punojnë drejt këtij qëllim. Prandaj, Agjencia gjatë vitit 2017 organizoi kampanje informuese për rëndësinë e përfaqësimit prej 50% me rastin e të dyja palë zgjedhjeve në nivel lokal dhe qendrorë, me publikimin e materialeve promovuese, dhe adresim të drejtpërdrejtë tek partitë politike, institucionet dhe mediat, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Administratës Publike për respektimin e përfaqësimit gjinorë në komitetet e përhershme në nivelin lokal.

Ligji për Barazi Gjinore është një ligj i rëndësishëm i drejtohet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, dhe jo rrallëherë keqkuptohet. Sikurse çdo ligj tjetër, edhe ky ligj është një ligj për të gjithë publikun, që ofron të drejta dhe shënon detyrime për të gjithë pa përjashtim.

Është e domosdoshme të kuptohet se efektiviteti i një ligji nuk lidhet vetëm me të, por dhe me institucionet

e parapara për zbatimin e ligjit. LBGJ, ndonëse monitorohet nga Agjencia për Barazi Gjinore, duhet të zbatohet prej të gjitha strukturave institucionale dhe organizative qoftë në sektorin, publik ashtu dhe në atë privat. Me qëllim të interpretimit të saktë të obligimeve dhe përgjegjësi ABGJ ka hartuar “Komentarin e Ligjin për Barazi Gjinore” me qëllim të njohjes së përafërt me te drejtat dhe obligimet institucionale, publike dhe sociale karshi barazisë gjinore.

Agjencia ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë në drejtim të afirmimit të të drejtave të garantuara duke insistuar në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave, përmes ndarjes së subvencioneve, duke insistuar se zhvillimi ekonomik shkon përtej të ardhurave të grumbulluara, është cilësia e jetës, gatishmëria jonë për tu përballë me sfida. Gratë dhe vajzat në Kosovë në përditshmërinë e tyre, në nivele alarmante të papunësisë përkundër shkollimit dhe obligimeve të shumta ndaj familjes dhe shoqërisë, me sfidat me të cilat ballafaqohen çdo ditë e dëshmojnë se janë forca më vitale e kësaj shoqërie, që mund ta ndryshoj në të mirë situatën në Kosovë duke kërkuar dhe gëzuar të drejtat e garantuara, dhe duke u angazhuar dhe ndërmarrë iniciativa që sigurojnë mirëqenie dhe paqe.

ABGJ falënderon popullin suedez, Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtarë - SIDA, për mbështetjen bujare që na e ka ofruar edhe gjatë vitit 2017, përmes ndihmës financiare dhe ekspertizës sipas projektit “Për fuqizimin e rolit të Agjencisë për Barazi Gjinore në Kosovë”.

Faleminderit,

Edi Gusia

Kryeshefe Ekzekutive

Agjencia për Barazi Gjinore

Zyra e Kryeministrit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Me qëllim që të afirmohen dhe të sigurohet vendimmarrja politike dhe ekzekutive në Komuna, reflektimi i barazisë gjinore është reflektim i drejtpërdrejtë si dhe jetësim i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar që të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim, me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

MAPL-ja në kuadër të mandatit të saj, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e komunave, ka për obligim që, nëpërmes mekanizmit ligjor të shqyrtimit të detyrueshëm të akteve të komunave, të sigurojë që të drejtat dhe interesat e qytetarëve të respektohen.

Duke qenë në dijeni për nivelin e ulët të përfaqësimit të gjinisë femërore në organet dhe trupat e komunave të Republikës së Kosovës, ne morëm iniciativa konkrete, respektivisht, së bashku me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Zyrën e Kryeministrit në muajin dhjetor të vitit të kaluar kemi përgatitur dhe përcjellë në komuna shkresën për "Barazi Gjinore" ku kemi kërkuar që "Organet komunale janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve".

Pas kërkesës sonë për respektimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor, respektivisht krijimit të hapësirave dhe kushteve për rritjen e numrit të përfaqësimit të gruas në organet ekzekutive dhe trupat e kuvendit të komunës, ne jemi kujdesur që nëpërmes mekanizmit ligjor të shqyrtimit administrativ të mos konfirmohet ligjshmëria e asnjë vendimi të komunave të cilët nuk përbëjnë përfaqësim të duhur për të dy gjinitë në komitetet e përhershme të kuvendeve të komunave, atë për Politike dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete. Në këtë proces ne kemi kthyer të gjitha ato vendime që nuk kanë përmbushur këtë standard, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit përkatës dhe ndryshimin e tij në atë mënyrë që të sigurohet përfaqësim i duhur në këto komitete për të dy gjinitë.

Si rezultat i këtyre angazhimeve dhe bashkëpunimit të ngushtë me komuna, sot pozita e grave në organet e komunave është shumë më e mirë, respektivisht përfaqësimi i tyre është në nivelin shumë më të mirë në Komitetet Obligative, ku sot kemi një përfaqësim prej 40% të përbërjes nga gjinia femërore, që dallon dukshëm nga mandati i kaluar ku nuk kishte kaluar 25% i tyre, si dhe në pozitë, si: Për dallim nga mandati i kaluar ku nuk ishte emëruar asnjë nënkryetare femër, në këtë mandat deri sot janë të emëruara dy nënkryetare të komunave; ndërsa avancim të theksuar në pozitë ekzekutive kemi tek emërimi i drejtoreshave të drejtorive nëpër komuna, ku për dallim nga mandati i kaluar ku kishim vetëm 10% të tyre nga gjinia femërore, sot kemi diku 18% të drejtorive të cilat udhëhiqen nga gjinia femërore; Gjithashtu sot kemi më shumë Kryesuese të Kuvendeve të Komunave, nga 3 sa ishin në mandatin e kaluar, tash janë zgjedhur 6 kryesuese.

Ne mbesim të përkushtuar në punën tonë drejt krijimit të kushteve dhe hapësirave për përfaqësim të barabartë gjinor, respektivisht avancimit të rolit të gruas në pozitë udhëheqëse në MAPL dhe organet komunale.

Faleminderit,

Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Vlerësimi i ndikimit gjinor- si kontribut për politika progjinore dhe zhvillim të qendrueshëm

Ndërmarrja dhe zbatimi i një politike publike mbart gjithmonë ndikime, të cilat jo rrallëherë nuk përkojnë me synimet që planifikohen të përmbushen për zbatimin e tyre. Si parim, politikat publike, qofshin këto në formën e ligjeve apo atyre zhvillimore si strategji, plane veprimi apo programe kombëtare, ndërmerren për të përmirësuar rritjen ekonomike dhe në përftim të qytetarëve dhe grupeve të caktuara të cilave u adresohen.

Edhe në Kosovë, Qeveria dhe institucionet e administratë publike ndërmarrin politika publike të natyrave të ndryshme, por që kanë një qëllim final, atë ngushtimit të pabarazisë shoqërore dhe mirëqenien e qytetarëve. Rritja e pabarazisë ekonomike-shoqërore është problemi më i madh me të cilin përballen të gjitha qeveritë në nivel global dhe mund të konsiderohet si problem kryesor i shekullit XXI. Për këtë arsye, në vitet e fundit, janë ndërmarrë një seri nismash në nivel global, kontinental, rajonal e kombëtar për ngushtimin e pabarazisë si nga OECD, Bashkimi Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar që përkojnë me një qasje dhe koncept të ri atë të “rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse” që shkojnë përtej politikave tradicionale “pro-rritjes ekonomike”, të konsideruara tashmë të pamjaftueshme madje të fajësueshme për thellimin e hendekut të pabarazive shoqërore-ekonomike.

Koncepti dhe qasja e re për një rritje gjithëpërfshirëse ekonomike kërkon një formë të re të menduari sipas së cilës përmirësimi i mirëqenies shoqërore, krahas standardeve të të mirave materiale të jetesës, mbetet objektivi final i politikë-bërjes.

OECD e përkufizon rritjen gjithëpërfshirëse ekonomike si rritje ekonomike që kriojnë mundësi për të gjitha segmentet e popullatës dhe shpërndarjen e rritjes së mirëqenies, në vlerë monetare dhe jo-monetare, me drejtësi në mbarë shoqërinë.” Përmirësimi i jetës së qytetarëve kërkon që të merret në konsideratë jo vetëm rritja ekonomike por edhe faktorë social si shëndeti, arsimi, punësimi, barazia dhe qasja ndaj burimeve, drejtësisë, dhe të drejtave. Pra sikurse shihet, ky koncept i ri ka natyrë shumëpërmasash.

Një rol të rëndësishëm për të realizuar qëllimin e rritjes gjithëpërfshirëse luan edhe mënyra dhe proceset, mjetet me të cilat politikat publike hartohen. Pra, suksesi i realizimit të synimit për rritje gjithëpërfshirëse fillon që në fazën e ngjizjes së politikave publike. Kjo fazë, në ciklin e hartimit të politikave të Kosovës, përkon me fazën e hartimit të koncept notave për politikat që propozohen për hartimin e projektligjeve apo strategjive, planeve të veprimit apo programeve kombëtare. Gjatë hartimit të tyre një grup instrumentash të quajtur Instrumentet për Vlerësimin e Ndikimit përdoren për të matur ndikimin shumëpërmasash të politikave publike të ndërmarrja. Një nga këto instrumente është dhe Vlerësimi i Ndikimit të Barazisë Gjinore. Instrumenti Vlerësimi i Ndikimit të Barazisë Gjinore ka si synim identifikimin e efekteve të ndërhyrjeve të ndryshme të politikave që ndërmerren në marrëdhëniet gjinore në shoqëri.

Zbatimi i këtij instrumenti mundëson matjen e ndikimit të politikave, përmasat e ndikimit, efektet negative dhe pozitive, identifikimin e grupeve dhe nëngrupeve që preken ose lihen jashtë ndërhyrjes së politikave të propozuara por që duhet të përfshihen dhe të përfitojnë prej zbatimit të tyre, sikurse mundëson që përmes analizës të propozohen dhe masat konkrete, reale për të zhbërë dhe kundërpërgjegjur efekteve negative potenciale të ndërhyrjeve të politikave të propozuara. Projekti për Forcimin Institucional të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave të Barazisë Gjinore në Kosovë, i financuar nga Qeveria Suedeze – Sida, është përfshirë në zbatimin e këtij instrumenti e deri më sot ka hartuar dokumentet në vijim: Mjeti për Matjen e Ndikimit Gjinor dhe Manualin për Zbatimin e Vlerësimit Ndikimit të Barazisë Gjinore. Një seri trajnimesh dhe sesione orientuese janë paraparë të mbahen për zbatimin e VNGJ-së gjatë vitit 2018-të dhe 2019-të, aktivitete në të cilat parashihen të trajnohen të gjithë shërbyesit civilë që marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave gjinore.

Materialet e hartuara, marrin në konsideratë koncepte dhe parime të barazisë gjinore në përgjithësi,

parime të metodave socio-ekonomike, kulturore dhe antropologjike kërkimore bazuar në teoritë gjinore, Konventën për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas, Platformën e Pekinit, Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Barazi Gjinore. Gjithashtu, dokumentet e hartuara janë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe mësimet të nxjerra nga vlerësimet që u është bërë zbatimit të këtij instrumenti në vendet e Bashkimit Evropian, Azi dhe Amerikën e Veriut.

Zbatimi i suksesshëm i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor, ashtu sikurse dhe për zbatimin e instrumenteve të tjerë do të varet nga vendosja e procedurave adekuate dhe në përputhshmëri me aktet normative, të rigorozitetit të zbatimit të procedurave dhe akteve normative, ndryshimeve në proceset e vendim-marrjes dhe rritjes së llogaridhënies për zbatimin cilësor të instrumenteve rregullativ përkitazi me problemin që synohet të adresohet. Njëkohësisht, domosdoshmërisht për një aplikim cilësor Vlerësimit të Ndikimit Gjinor, duhet të ndodhë adresimi i normave kulturore dhe stereotipeve brenda institucioneve nga politikë-hartuesit që çështjet gjinore i shohin si përgjegjësi të zyrtareve për barazi gjinore apo Agjencisë për Barazi Gjinore. Ky fenomen i cili rezultoi në segregimin e insitucional të çështjeve gjinore duke ndikuar negativisht në hartimin cilësor të politikave publike të cilat duhet të marrin në konsideratë dhe adresojnë në formë adekuate nevojat e identifikuar si rezultat i pabarazive gjinore që ekzistojnë në shoqërinë kosovare. Përmes zbatimit të masave adekuate dhe realiste, politika publike e propozuar, si rezultat i zbatimit rigoroz të Vlerësimit të Ndikimit Gjinor do të ndikojë në zhvillime pozitive që sigurojnë: gëzimin e të drejtave të barabarta si për burrat dhe për gratë, ridefinimin e roleve në shoqëri, ndryshime institucionale, rishpërndajre dhe akses të barabartë në burimet financiare e natyrore të vendit, si individë dhe qytetarë të barabartë dhe pjesëmarrës aktiv në realizimin e të drejtave individuale dhe vendim-marrjen e përcaktimit të fateve të vendit.

Blerinda Idrizi

Udhëheqëse e Projektit, Forcimi Insitucional për ABGJ dhe Mekanizmave Gjinor /Dada6 Niras

Prezantohet Komentari i Ligjit për Barazi Gjinore



Foto e realizuar nga lansimi i Komentarit të LBGJ-së

Me qëllim të trajtimit të barabartë para ligjit dhe avancimin e të kuptuarit të Ligjit për Barazi Gjinore (LBGJ), Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar Komentarin e këtij ligji. Komentari synon të ofroj sqarime, interpretime, dhe udhëzime adekuate nën për nën se si duhen zbatuar parimet e ligjit, si dhe sqaron obligimet për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për trajtimin e barabartë të të dy gjinive. Po ashtu komentari sqaron normat në lidhshmëri me ligjet e tjera, me praktikën gjyqësore duke ofruar udhëzime të zbatimit në praktikë, dhe ky fakt do të lehtësoj dukshëm jo vetëm punën e gjyqësorit, por të gjitha institucioneve në të kuptuarit dhe avancimin e barazisë gjinore. Komentari është realizuar me mbështetjen e SIDA's, dhe është publikuar nga Agjencia në 700 kopje në tre gjuhë. Në prezantimin e Komentarit morën pjesë 150 pjesëmarrës, takimin e hapi

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Komentari është shpërndarë në gjykata dhe prokurori themelore.

Fjalë rasti mbajti edhe Znj. Selvetë Gërçhalij – Krasniqi, në emër të Gjykataës Kushtetuese Zt. Nehat Idrizi – Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Zt. Hilmi Jashari -Avokati i Popullit dhe Autor i Komentarit Zt. Haxhi Gashi.

Komentari është realizuar me mbështetjen e SIDA's, dhe është publikuar nga Agjencia në 700 kopje në tre gjuhë. Në prezantimin e Komentarit morën pjesë 150 pjesëmarrës

Agjencia për Barazi Gjinore gjatë vitit 2017 ka ofruar komente dhe ekspertizë me perspektivë gjinore në 27 draft akte-nënligjore, si dhe 7 draft politika publike të propozuara.

Prezantohet dhe shpërndahet Komentari i Ligjit për Barazi Gjinore, në fakultetin Juridik

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me përfaqësues të Fakultetit Juridik kanë prezantuar para studentëve të këtij fakulteti, komentarin e Ligjit për Barazi Gjinore.

Studentëve në këtë rast ju shpërndan 200 kopje të komentarit dhe gjithashtu u shpërndan edhe kopje të Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe disa kopje të koncepteve dhe përkufizimeve gjinore.

Komentari u realizua me mbështetjen e SIDA's



Foto nga prezantimi i Komentarit të LBGJ



Biblordi i realizuar për promovimin e LBGJ

Hartimi i kurikulës së trajnimeve për trajnerë, në fushën e barazisë gjinore



Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP) kanë përgatitur kurikulen e re për barazi gjinore dhe kanë bërë selektimin dhe organizimin e trajnimit të parë, për trajner në fushën e barazisë gjinore. Qëllimi i këtij trajnimi ishte që kandidatët që kanë aplikuar për tu bërë trajnerë për Barazi Gjinore të njihen

me afër me shkathtësitë dhe metodologjinë e trajnimit dhe për të fituar njohuri të reja rreth barazisë gjinore. Gjatë këtyre ditëve pjesëmarrësit janë njohur më afër me modulet që do të prezentohen gjatë trajnimeve. I gjithë trajnimi ishte fokusuar me ligjërime dhe prezente nga pjesëmarrësit si dhe punë individuale. Janë trajnuar 12 trajner. Po ashtu ABGJ ka

mbajtur trajnim për grupin punues –MASHT për rishikimin e kurrikulës së teksteve shkollore me perspektivë gjinore.

Trajnimi është ndarë në dy pjesë, dy ditët e para janë mbajtur me 21 dhe 22 mars 2017 në Prishtinë, kurse tri ditët tjera 27-29 janë mbajtur në Durrës, Shqipëri. Ky projekt është mbështetur nga organizata gjermane GiZ.

Zbatimi i Buxhetimit të përgjegjshëm gjinorë

Në përputhje me Nenin 5 të Ligjit për barazi gjinore institucionet e Republikës së Kosovës, të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor janë përgjegjëse për të përfshirë buxhetimin gjinor në të gjitha fushat si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është strategji për integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin ekonomik dhe në buxhetin qeveritar. ABGJ në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ka themeluar grupin punues për hartimin e Koncept Dokumentit për zbatimin e buxhetimit gjinorë në nivel vendi në mënyrë

uniforme. Koncept dokumenti është në fazën e finalizimit dhe pas miratimit në Qeveri do të hapë rrugë hartimit të një akti nën-ligjorë për zbatimin



e BPGJ. Për ti njoftuar qytetarët/et me konceptin e BPGJ kemi realizuar videoklip i cili është duke u transmetuar në RTK.

ABGJ ka mbajtur punëtorin për hartimin e koncept dokumentit për buxhetim gjinor

Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar punëtorinë e dytë për hartimin e koncept dokumentit për buxhetimin gjinorë, grupi punues nën udhëheqjen e ABGJ dhe Ministrisë së Financave për dy ditë radhasi kanë qëndruar në Republikën e Shqipërisë, krahas kësaj punëtorie janë zhvilluar edhe disa takime në Institucionet e Shqipërisë lidhur me zbatimin e buxhetimit gjinor. Përfaqësues nga Shqipëria prezantuan procesin, arritjet dhe sfidat me të cilat po ballafaqohen. Me këtë rast delegacioni është takuar me Ministren e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Olta Xhaçka dhe me disa përfaqësues nga kjo ministri.

Grupi punues në përbërje ka : përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore, Ministrisë së



Foto e realizuar nga punëtorja për buxhetim gjinor

Financave, Zyrës Ligjore- ZKM, Sekretariatit Koordinues –ZKM, si dhe Zyrës për planifikim strategjik –ZKM.

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizu viztë studimore në Vienë, të Austrisë



Foto nga punëtorja për buxhetim gjinor, Austri

Përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me përfaqësues të Institucioneve nga Zyra e Auditimit, Ministria e Financave, Zyra e Prokurimit, Zyra Ligjore, Sekretariati Kordinues si dhe nga Zyra për Planifikim Strategjik për pesë ditë radhazi, zhvilluan vizitë studimore në Vienë, të Austrisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja për së afërmi, mbi procedurat e aplikimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor, ku gjatë kësaj kohe u

mbajtën dy punëtori po me këtë temë.

Vizitat u realizuan në, Parlamentin Austriak, Kancelarinë Federale, Ministrin e Financave, Ministrin e Shëndetësisë dhe për Çështje të Grave, si dhe në Gjykatën e Auditorëve, të gjitha këto takime u mbështetë me ndërmjetësimin e projektit “Forcimi i kapaciteteve institucionale të ABGJ-së, dhe mekanizmave gjinor në Kosovë”, zbatuar nga konsorciumi Indeevelop DADA6 Niras, financuar nga SIDA .

Agjencia për Barazi Gjinore bazuar në planin e punës për vitin 2017 dhe prioritetet e parapara si ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e njohurive dhe informatave, në mbështetje të Giz – Gjerman, ka organizuar vizitë pune në Republikën Federale të Gjermanisë/Berlin. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja e metodologjisë së punës për hartimin e koncept dokumentit për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjnor dhe mënyrat e bashkëpunimit me akteret kryesor.

Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin Zyrarët e ABGJ-së, Ministria e Financave, ZKM,SKQ/ZKM. Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan disa takim njoftues mbi procedurat e përgjithshme për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjnor. Takimi u mbajt me Gabriele Kamper/Udhëheqëse e Zyrës për Barazi Gjinore, me përfaqësueset nga Iniciativa e grave jo-partiake të qytetit të Berlinit E.V (UPFI) Bergit Hartings / Anëtarë e Bordit dhe Carola von Braun Zëdhënëse. Në ditët në vijim grupi punues u takua edhe me Mara Kuhl shkencëtare dhe këshilltare për administratë dhe politikë, Kristine Rabe /ish zyrëtare e zyrës për Mundësi të Barabarta në Distriktin Charlottenburg – Wilmersdorf të Berlinit, Ekin Deligoz e Grupit parlamentar i të Gjellberve /Aleanca 90 si dhe me Torsten Puhst, shefe e Departamentit për Politika Fiskale dhe Buxhet.

Përfaqësuesit e Instucioneve të Republikës së Kosovë të kryesuar nga ABGJ ishin në vizitë pune në Berlin të Gjermanisë



Foto e realizuar nga vizita në Berlin, Gjermani

Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar trajnimin “Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnor dhe Analiza e Buxhetit”

Agjencia për Barazi Gjinore, ka organizuar trajnimin me 6 dhe 7 Dhjetor, lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm Gjnor dhe Analizën e buxhetit për stafin e ABGJ-së, Ministrin e Financave, Zyrarët Financiar, si dhe analistë të buxhetit.

Qëllimi i këtij trjanimin ishte njohja për së afërmi, mbi procedurat e aplikimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjnor. Trajnim ishte i ndarë në katër sesione : në sesioni e parë është diskutuar lidhur me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjnor, Konceptet kyçe dhe Qasjet, sesioni i dytë vazhdoj me Integrimin e BPGJ-së në Qarkun Buxhetor, derisa sesioni i tretë me Analizat e Buxhetit Gjnor dhe Paraqitjen e ndryshimeve relevante në Programe dhe Alokimet Buxhetore, derisa sesioni i fundit është diksutuar lidhur me Rishikimin e praktikave të mira dhe shembujve të punës së BPGJ-



Foto nga trajnimi “Buxhetimi Gjnor dhe Analiza e Buxhetit”

së. Trajnimi u mbajt nga Ekspertja e angazhuar, Dr. Elisabeth Klatzer nga Austria e cila përveq temave të lartpërmendura prezantoi dhe praktikat e buxhetimit gjnor se si është i rregullur në shtetin Austriak .

Ky trajnim është organizuar me qëllim të Forcimit të kapaciteteve institucionale të ABGJ-së, dhe mekanizmave gjnor në Kosovë, i zbatuar nga koneserciumit Indvelop DADA6 Niras, financuar nga SIDA.

Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar Strategjinë për Komunikim, Avokim dhe Marrëdhënie me Publikun

Me Strategjinë për Komunikim, Avokim dhe Marrëdhënie me publikun të hartuar nga ABGJ definohen rrugët dhe mjetet që do të shërbejnë për shkëmbimin e informatave dhe të dijes, si dhe përfshirjen e akterëve të shumtë në aktivitetet që synojnë ndryshimin e sjelljes dhe të praktikave, qoftë të institucioneve qoftë të audiencave e publikëve shumështrësor të Kosovës.

Strategjia do t'i vendos bazat orientuese për komunikim e avokim efektiv brenda institucional e ndër institucional,

për komunikim profesional me partnerët, si dhe bazat e marrëdhënjeve të suksesshme me mediat dhe publikun.

Janë disa objektiva që synohen të arrihen me këtë strategji të cilët janë afatgjatë dhe kanë të bëjnë me rritjen e shkallës së informimit të të gjithë segmentëve shoqëror për rëndësinë e barazisë gjinore dhe të avansojë komunikimin ndërinstitucional me marrëdhëniet me publikun, me qëllim të bashkërendimit të veprimeve dhe krijimit të një fronti të përbashkët në luftimin e pabarazive që do të krijonte

një shoqëri të shëndoshë e pa dallime gjinore - një shoqëri që ka në epiqendër interesin e secilit njeri dhe që ofron mundësi të barabarta për të gjithë.

Implementimi i Strategjisë do të mundësojë që të gjithë partnerët dhe grupet e interesit të mbahen të informuara vazhdimisht me zhvillimet, rjedhat e risitë përkitazi me barazinë gjinore, me hapat për fuqizimin ekonomik e politik të grave dhe vajzave, si dhe me hapat që ndërmerren për ç'rrenjosjen e stereotipeve gjinore dhe luftimin e dhunës në familje.

Studentët e Universitetit Veror u priten në takim nga Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e ABGJ



Foto nga takimi me studentë

Studentet nga Kosova dhe studentë nga vendet e ndryshme të botës, të cilët janë duke ndjekur Universitetin Veror të Prishtinës, u priten në takim nga Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia.

Takimi u mbajt me synim që studentet të njoftohen me punën e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe punën e

Qeverisë së Republikës së Kosovës sa i përket qasjes së Institucioneve të Kosovës në fushën e barazisë gjinore. Pjesëmarrësit në këtë takim kanë qenë studentet të cilët studjohë në drejtime dhe nivele të ndryshme studimi. Në takim, Kryeshefja Ekzekutive, Edi Gusia mbajti një prezantim lidhur me punën dhe fushën e veprimin e ABGJ-së.

Initiativat e Agjencisë për Barazi Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore organizoni takimin e parë me Grupin Koordinues për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Takimi u hap nga Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, e cila i uroj mirëseardhje të pranishmëve dhe i njoftoj me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e grupeve të punës për hartimin e Programit.

Në këtë takim Blerinda Idrizi, Udhëheqëse e Projektit për “Forcimin Institucional të ABGJ-së dhe Mekanizmave Gjinorë në Kosovë”, projekt i financuar nga Qeveria Suedeze – Sida dhe zbatuar nga Konsorciumi Niras, Indevlop, DADA6, prezantoi para grupit punues metodologjinë e hartimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Po ashtu, u diskutua lidhur me fillimin e grupeve punues për hartimin e PKBGJ-së, ku do të marrin pjesë rreth 60 pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve të Kosovës, shoqërisë civile, dhe komunitetit ndërkombëtar. Në takim mori pjesë dhe Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë Munir Basha i cili është dhe Koordinatori Nacional për Strategjinë e Dhunës në Familje, i sapo emëruar në këtë detyrë.

Mbahet takimi i parë njoftues për Hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore



Ka filluar punën grupi punues për hartimin e PKBGJ-së

Në përmbushje të obligimit ligjorë Neni 11 i Ligjit për Barazi Gjinore, ABGJ ka filluar me hartimin e Programit të ri të Kosovës për Barazi gjinore (PKBGJ), si dokument strategjik i Qeverisë së Kosovës, i cili përcakton synimet masat dhe aktet kryesor që janë përgjegjës për arritjen e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës sociale, ekonomike, politike, arsimore, shëndetësore dhe kulturore për gratë dhe burrat në Kosovë në vitet 2017-2020.

Me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës Isa Mustafa me datën 23/12/2016 është emëruar ekipi qendror për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

Ky dokument është instrument planifikues për të zbatuar aktivitetet relevante dhe politika publike, si dhe zhvillimin e kapaciteteve për përfshirje të perspektivës gjinore në nivel vendi. Deri më tani është hartuar dokumenti i analizës



Foto e realizuar nga grupet punuese për hartimin e PKBGJ

Dokumenti është i ndarë në tri shtylla:

- Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale
- Zhvillimi njerëzor
- Vendimmarrja dhe përfaqësimi, Gratë, Paja dhe Siguria

së situatës së tanishme, janë përgatitur draftet e para për tre fushat relevante dhe janë mbajtur punëtoritë me grupet punuese për gjashtë ditë radhazi ka, ku është diskutuar lidhur me mbledhjen, analizimin dhe ofrimin e informatave të nevojshme gjatë dhe deri në përfundim të procesit të finalizimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit. I tërë procesi është mbështetur nga nga SIDA.



Sekuenca nga realizimi i videospotit për vazhdimin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve

Zgjatet afati për Regjistrimin pa Pages të Pronës në Emër të dy Bashkëshortëve

Me qëllim të përmirësimit të situatës së grave përmes rritjes së qasjes së tyre në pronë, ABGJ në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës i ka propozuar Qeverisë vazhdimin e qëndrimit në fuqi të masës afirmative:

“Udhëzimi Administrativ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë”. Masa afirmative është miratuar nga QRK dhe do të jetë në fuqi deri në Prill 2018. Me këtë rast, ABGJ ka organizuar fushatë promovuese, përmes realizimit të videoklipit promovues i transmetuar në RTK dhe tre televizione lokale, janë publikuar 120 posterë dhe billborda në tërë territorin e RKS. Deri në dhjetorë të vitit 2017, **1197** çifte kanë përfutur nga mundësia e regjistrimit të pronës pa pagesë në nivel vendi. UA është prezantuar nga ABGJ në komunat: Prishtinë, Ferizaj, Lipjan, Obiliq dhe Fushë-Kosovë etj, si dhe në ministritë e linjës.



Bilbordi :Regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë”

ABGJ priti në takim Anëtarët e Korpusit të Paqës



Foto e realizuar me Anëtarët e Korpusit të Paqës

Agjencia për Barazi gjinore ka pritur në takim përfaqësuesit e organizatë së Korpusit të Paqës – SHBA, si vazhdimësi e bashkëpunimit të filluar më herët. Në këtë takim ishin prezent edhe zyrtaret për barazi gjinore të nivelit komunal, me qëllim që secila nga zyrtaret të takohet përseafërmi dhe të njoftohen me vullnetarët/et e angazhuar në Korpusin e Paqës të cilët/at veprojnë në baza vullnetare në

komunat nga vijnë edhe zyrtaret.

Udhëheqësja e Korpusit të Paqës në Kosovë, Darlene Grant, i njoftoi të pranishmit me historikun e themelimit të Korpusit të paqës që daton nga viti 1961 dhe punën e vullnetarëve të angazhuar në promovimin e demokracisë, vlerave dhe parimeve amerikane. Në Kosovë veprojnë për momentin 61 vullnetarë në 27 Komuna. Një nga parimet

themelore të kësaj organizate është promovimi i barazisë gjinore dhe avancimi i të drejtave të grave dhe vajzave. Pra, qëllimi i takimit mes dy palëve ishte bashkëpunimi në aktivitete të ndryshme, duke filluar nga organizmi i kurseve të gjuhës, aktiviteteve për promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave dhe vajzave, senzibilizimin e opinionit përmes fushatave të përbashkëta etj.

U mbajt takim pune me Donatorë, me fokus në Barazinë Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar takim punue me e donatorë, me fokus të veçantë në barazinë gjinore. Në këtë takim të përbashkët të gjitha palët prezantuan planet dhe aktivitete që kanë të bëjnë me fushën e barazisë gjinore, me qëllim të mosduplikimit të aktiviteteve të njëjta nga ana e ABGJ-së dhe donatorëve. Takim u zhvillua në tri sesione në, në sesionin e parë u diskutuan lidhur me Fuqizimin ekonomik të grave (Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe punësimi dhe e drejta pronësore), derisa Sesioni i dytë kishte të bëjë me aktivitete dhe koordinimin lidhur me Forcimin e administratës publike dhe integrimi gjinor (Forcimi institucional i administratës publike dhe barazia gjinore,



Takim me donator në fushën e barazisë gjinore

Buxheti gjinor dhe Hartimi dhe zbatimi i politikave gjinore dhe me perspektivë gjinore) dhe perfundoj me Sesionin e Tretë - Drejtësia tranzicionale dhe Dhuna në familje (Strategjia Kombëtare e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Tranzicionale).

Mbahet takimi i grupit koordinues kundër dhunës në familje

Bazuar në mandatin e Agjencisë për Barazi Gjinore si zëvendëskoordinatorë dhe zëvendëskryesuesë e grupit koordinues kundër dhunës në familje në mungesë të koordinatorit nacional për dhunën në familje dhe me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe prezantimit të punës së deritanishme por edhe sfidave, ABGJ ka ftuar në takim përfaqësuesit e Grupit Koordinues në përbërje të : Vehbi Mujku -Drejtor i Qendrës për Punë Sociale, Bastri Kastrati-Mrojtësit e viktimave/Prokuroria e Shtetit, Adile Basha-MPMS, Nazmije Kajtazi – MSH, Nazife Jonuzi - Strehimorja në Gjilan.

Në këtë takim ABGJ prezantoi aktivitete të cilat janë realizuar, dhe që priten të realizohen gjatë vitit 2018, në fushën e dhunës në familje si dhe obligimet që kjo Agjenci ka në Strategjinë kombëtare kundër dhunës në familje 2018 -2020. Si bartëse e procesit të hartimit të PSVE-ve ABGJ ka planifikuar të

amandamentoit PSV-të, por paraprakisht do të realizohet vlerësimi i zbatimit të PSV-ve në nivel vendi në bashkëpunim me donatorin e identifikuar i cili vlerësim do të paraqes, se cilat janë sfidat dhe pengesat e deritanishme në zbatimin e këtyre procedurave.

Koordinimi ndërinstitutional vazhdon të mbetet një nga hallkat me sfiduese të sistemit referues dhe grupi u dakordua që të vazhdohet me takime koordinuese.

Rëndësi e veçantë u tha se do të kushtohet koordinimit të trajnimeve për dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore në nivel vendi, duke u përkujdesur të mos anashkalohen kompetencat e institucioneve dhe të mos shkarkohet huti tek qytetaret për llojin e shërbimeve dhe ndihmës të cilën janë të obliguar ta ofrojnë institucionet e ndryshme. Ndër të tjera gjatë takimit u tha se të gjithë mekanizmat institucional të përgatitjen raportin dhe deri në

janar të dorzojnë në ABGJ, në mënyrë që të kemi një raport të permblodhur narrativ për rastet.

Në këtë takim u thekua se Statistikat e mbledhura në mënyrë uniforme dhe të harmonizuara në nivel ndër-institutional dhe me strehimoret vazhdojnë të mbesin sfidë e raportimit dhe përcjelljes së rasteve, mbështetja finaciare me buxhet adekuat për qendrat për punë sociale vazhdon të jetë sfiduese.

Po, ashtu u konstatua se sfidë vazhdon të mbetet mos funksionimi i Strehimoreve në Prishtinë dhe financimi i Strehimoreve tjera, MPMS i ka kryer të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me Financimin në kontinuitet të strehimoreve. Nëse nuk vazhdohet të punohet në kontinuitet strehimoret rrezikojnë qëndrueshmërinë finaciare dhe përkujdesjen ndaj rasteve dhe tanime pritet të merret vendim nga Qeveria dhe MF.

Miratohet Rregullorja për sistematizimin e brendshëm të Agjencisë për Barazi Gjinore

Rregullore QRK - Nr. 06/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Barazi Gjinore, është miratuar në mbledhjen e 145 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.04/145,

datë 15.05.2017.

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e përgjegjësiave dhe organizimin e brendshëm të Agjencisë për Barazi Gjinore.

Agjencia do të funksionojë sipas organogramit të

saj, duke respektuar hierarkinë dhe shtrirjen horizontale ku njësitë organizative të Agjencisë do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim të funksionimit efikas për arritjen e objektivave kryesore të Agjencisë.

https://abgj.rksgov.net/Portals/0/Rregullore_p%C3%ABr_Organizimin_e_brendshem_dhe_sistematizimin_e_vendeve_te_punes_ABGJ.pdf



Foto e realizuar gjatë shënimit të 8 Marsit- Dita Ndërkombëtare e Gruas

Agjencia për Barazi Gjinore ka shënuar 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas me publikimin e raportit për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013 dhe prezantimin e të dalurave nga hulumtimi “Gratë ne Mediat e shkruara” 2014-2015.

Në këtë ceremoni, pjesëmarrës

Agjencia për Barazi Gjinore ka shënuar 8 Marsin - Ditën Ndërkombëtare të Gruas

ishte Kryeministri i Republikës së Kosovës- Isa Mustafa, Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së Edi Gusia, Ambasadori i Suedisë në Kosovë-Henrik Nilsson, Ministria për Integritet

Evropiane-Mimoza Ahmetaj, zëvendësministria e Zhvillimit Ekonomik-Besa Zogaj Gashi, si dhe zëvendësministria e Integritet Evropiane-Anila Statovci.

Vlerësimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore

Raportit për zbatimin e PKBGJ është bërë me kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Barazi Gjinore të Kosovës në lidhje me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin periodik mbi zbatimin e politikave publike të Kosovës nga perspektiva e barazisë gjinore dhe zotimin e ABGJ-së që të mësoj nga përvoja e mëhershme, objektivi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është që të përcaktojë se deri

në çfarë shkalle është arritur progresi në periudhën mes viti 2008 deri 2013, sa i përket përmbushjes së objektivave të PKBGJ-së. Ky vlerësim konfirmon se PKBGJ-ja ka qenë një dokument relevant pasi që identifikon sfidat kryesore të cilat e pengonin barazinë gjinore në Kosovë. Gjatë cilës jetësor të PKBGJ-së, janë zhvilluar disa strategji si dhe janë themeluar disa mekanizma

të ri institucional, duke synuar kështu të kontribuojnë në kuadër të agjendës për barazi gjinore në Kosovë.

Pavarësisht progresit që është arritur në disa nga treguesit e tregut të punës dhe atyre socio-ekonomik, deri në vitin 2013 gratë në Kosovë kanë qenë në pozita më të pa-favorshme në krahasim me burrat. Raporti i publikuar në tre gjuhë është prezantuar para institucioneve.

Mësimet e nxjerra/rekomandimet për PKBGJ e ardhshme

Në bazë të analizës së PKBGJ-së dhe praktikave më të mira në hartimin e programit dhe strategjive kombëtare, janë nxjerrë rekomandimet e mëposhtme:

- PKBGJ-ja e re duhet ti kushtoj vëmendje të veçantë analizës së kontekstit që do të çonte në identifikimin e sfidave; nga ana tjetër kjo do të shërbejë për përcaktimin e objektivave realiste dhe koherente, dhe për çdo objektiv duhet të planifikohen aktivitetet konkrete. Të gjitha këto elemente duhet të jenë të lidhura në mënyrë të qartë me njëra-tjetrën,
- Të sigurohet që të gjitha sfidat janë të përfshira në PKBGJ,
- Të sigurohet që PKBGJ adreson sfidat me të cilat përballen gratë dhe burrat,
- PKBGJ-ja e re duhet të përmbajë një analizë të kufizimeve/boshllëqeve në kornizën ekzistues ligjore, të cilat janë parakushte për arritjen e objektivave të përcaktuara,
- PKBGJ-ja e re duhet të përfshijë një analizë të shëndoshë të kapaciteteve të mekanizmave institucional përgjegjës për promovimin dhe sigurimin e barazisë gjinore, përkatësisht të akterëve kyç në zbatimin e Programit. Kjo pastaj duhet të shoqërohet me masa të veçanta për përmirësimin e kapaciteteve e nevojshme,
- PKBGJ duhet të i përshtatet qasjes së orientuar në rezultate përkatësisht objektivat, nën-objektivat dhe aktivitetet duhet të jenë specifik dhe të matshëm, duke kontribuar në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të programit,
- Kurdo që është e mundur, treguesit e gjendjes fillestare dhe asaj të synuar duhet të mbështeten në burime zyrtare dhe të rregullta të të dhënave, dhe jo në dëshmi nga hulumtimet ad hoc. Në rastin e kësaj te fundit, duhet të sigurohet përshkrimi i qartë i llogaritjes së treguesve,
- Indikatorët duhet të përcaktohen duke ndjekur qasjen SMART, pra duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe me afate kohore,
- Për secilin aktivitet, buxheti duhet të llogaritet me informacion të qartë mbi llogaritjen,
- Për secilin aktivitet, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse duhet të definojnë dhe të caktojnë, duke marrë në konsideratë fushat e tyre të autoritetit dhe mandatin,
- Mjete të thjeshta, por gjithëpërfshirëse të monitorimit duhet të shoqërojnë PKBGJ e re, dhe duhet të ofrohen trajnime adekuate për zbatimin e mjeteve, për të gjithë ZBGJ-të dhe të gjithë partnerët implementues,
- PKBGJ-ja e re duhet të parashikojë mekanizmat koordinues, me ABGJ që e kryeson strukturën dhe procesin koordinues. Kjo duhet të shërbejë si një instrument që siguron se ndërhyrjet ndërmerren duke ndjekur rendin e prioritetit, duke siguruar që janë bërë përparime në të gjitha fushat e PKBGJ-se dhe ruajtjen e përdorimit efikas të burimeve, dhe
- PKBGJ e re duhet të përmbajë një afat kohor për raportim të rregullt në Kuvendin e Kosovës, mbi progresin e arritur.

Ky vlerësim është mundësuar nga projekti “Fuqizimi Institucional i ABGJ dhe Mekanizmave Gjinator” që financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – SIDA”.

Prezantimin e Raportit të Vlerësimit të Programit të Kosovës për barazi gjinore 2008-2013” e bëri Ardiana Gashi nga konzorciumi “NIRAS/SIDA”.mff

<https://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Vleresimi%20PKDHFAP%202011-2014.pdf>



Foto nga prezantimi i hulumtimit "Gratë në mediat e shkruara"

Hulumtimi "Gratë në Mediat e shkruara" është bazuar në vlerësimin e artikujve të shtatë gazetave ditore të mbledhura gjatë viteve 2014-2015 që shtjellojnë tema të cilat kanë të bëjnë me vajzat dhe gratë. Qëllimi i hulumtimit ka qenë vlerësimi i prezantimit sasior dhe cilësor të grave në to, si dhe roli që shkrimet e gazetave ditore luajnë në krijimin e një klime të favorshme për luftimin e stereotipeve gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore. Për më shumë ky hulumtim ka për qëllim edhe përmbushjen e objektivave strategjike të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013, si dhe Planit të Veprimit të Bashkimit Evropian 2016-2020, të cilat përcaktojnë qartë detyrimet dhe obligimet e institucioneve publike, dhe institucioneve mandati i të cilave përkon me media, në lidhje me promovimin e barazisë gjinore.

Hulumtimi ka synim të vlerësojë se në çfarë mënyrë prezantohen

PUBLIKIMI I HULUMTIMIT: Gratë në mediat e shkruara 2014-2015"

gratë në mediat e shkruara, dhe në çfarë mase ushqehen apo luftohen stereotipet ekzistuese në lidhje me rolin e gruas në shoqërinë kosovare. Por, në një rrafsh më të gjerë, të dhënat nga hulumtimi i mëposhtëm mund të konsiderohen të dobishme edhe për faktin se japin një pasqyrë më të qartë të qasjes së mediave të shkruara ndaj çështjeve të ndjeshme politike, shoqërore e kulturore, si dhe një vështrim kritik mbi objektivitetin, etikën dhe mendësinë e gazetarëve, si bartës kryesorë të informacionit dhe akterë kyç në krijimin e diskursit publik.

Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë është siç vijon : Kjo matje tregon se Koha Ditore me 28.9% është gazeta me më së shumti shkrime që kanë të bëjnë me gratë, pasuar nga Kosova Sot me 25.8%, Bota Sot me 17.9%, Zëri me 12.9%,

Epoka e Re me 6.9%, Tribuna me 4.7%, dhe Lajmi me 2.9%. Gazetat me tirazhin më të lartë, Koha Ditore dhe KosovaSot, u japin hapësirë më të madhe artikujve që kanë të bëjnë me gratë, në krahasim me gazetatat tjera me tirazh më të ulët.

Hulumtimi është prezantuar edhe para gazetarëve, ku me ç'rastë u kërkua që mediat t'i kushtojnë hapësirë më të madhe grave dhe vajzave candidate në zgjedhjet lokale.

Përfundimet dhe Rekomandimet e mëposhtme janë bazuar në analizën e mësipërme të materialit të mbledhur për prezantimin e grave në mediat e shkruara për vitet 2014-2015, si dhe në bazë të gjetjeve nga grupi i fokusit dhe identifikimit të nevojës së përgjithshme për përmirësime të mëtutjeshme në këtë fushë:

- Organet vendimmarrëse të mediave të shkruara duhet të krijojnë mekanizma që mundësojnë raportim të balancuar në aspektin gjinor në të gjitha fushat. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojës që gazetarët të trajnohen dhe pajisen me njohuri adekuate mbi Treguesit e Ndjeshëm Gjिनorë për Media (GSIM) të UNESCO-s.
 - Bordet redaktoriale të mediave të shkruara duhet të krijojnë kushte për ofrimin e trajnimeve adekuate dhe të specializuara për gazetarët e tyre, me qëllim të raportimit profesional e cilësor në të gjitha fushat, e sidomos në ato ku vajzat dhe gratë janë protagonistet kryesore, siç janë shkrimet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, dhunën në familje, dhe gratë në politikë. Në këtë rrafsh, një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet përmirësimit të qasjes së gazetarëve në raport me shkrimet që ngërthejnë në vete nocione komplekse, siç janë morali, seksualiteti dhe normat e etabluara shoqërore e kulturore.
 - Qeveria e Kosovës, së bashku me Bordet redaktoriale të mediave të shkruara dhe shoqërinë civile, duhet të punojë në edukimin e qytetarëve, e sidomos të rinjve rreth perceptimit sa më real të shkrimeve dhe imazheve që u servohen në media, me qëllim të zvogëlimit të ndikimit që ato kanë në forcimin e stereotipeve ekzistuese.
 - Mediat e shkruara duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për promovimin e vajzave dhe grave të suksesshme, sidomos në fushat të cilat konsiderohen apriori burrërore.
 - Mediat e shkruara duhet të jenë më të kujdesshme që raportimet e gazetarëve, sidomos ato që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, t'u nënshtrohen kritereve strikte të raportimit objektiv dhe të ndjeshëm. Mbetet shqetësues fakti që dhuna ndaj grave shpeshherë raportohet si pjesë e kronikës së zezë apo ngjarjeve protokollare, me ç'rast vërehet mungesa e qasjes analitike dhe vetëdijesimit të lexuesve me qëllim të parandalimit të këtij fenomeni negative.
 - Mediat e shkruara duhet ta përmirësojnë qasjen e tyre ndaj promovimit të barazisë gjinore, jo vetëm përmes ofrimit të hapësirës së mjaftueshme, por edhe përmes ngritjes së cilësisë së shkrimeve të cilat do të ndikonin në vetëdijesimin e qytetarëve sa i përket barazisë gjinore në shoqëri, dhe në inkurajimin e vendimmarrësve për iniciimin dhe implementimin e politikave dhe praktikave adekuate që garantojnë barazi gjinore.
 - Institucionet e medias duhet të sigurojnë që Bordet e tyre menaxheriale dhe redaktoriale të kenë përfaqësim të balancuar gjinor.
- Institucionet akademike të përgatitjes së gazetarëve të ardhshëm, dhe më gjerë, duhet të konsiderojnë krijimin dhe përfshirjen e moduleve mbi barazinë gjinore në programin akademik shkollor.
- Shmangia nga gjuha që patronizon ose shpërfill gjininë grua dhe nga gjuha që forcon stereotipet dhe imazhet e pabarazisë gjinore, si për burrat ashtu edhe për gratë.
 - Mediat duhet të sjellin zërin e ekspertit në formë të balancuar, duke prezantuar si ekspertë burra, ashtu dhe eksperte gra. Krijimi i bazës së të dhënave apo listës së ekspertëve në baza gjinore nga institucionet mediatike do të ishte faktor ndihmues në këtë drejtim dhe do të krijonte një balancim gjinor, por njëkohësisht do të zgjeronte edhe përfaqësimin e shtresave dhe grupeve të ndryshme shoqërore dhe etnike, duke siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës të shoqërisë në faqet e mediave të shkruara.
 - Mandatimi i rregullatorit për media për përcjellje, analiza dhe raportime të rregullta mbi ndjeshmërinë gjinore të mediave, si dhe për vendosjen e sanksioneve të mirë specifikuara.
- Të gjeturat dhe rekomandimet e hulumtimit "Gratë në mediat e shkruara" i prezantojë z.Agon Maliqi, hulumtues nga kompania S&D Consulting.

Me poshtë janë linqet e mediave të cilat e kanë publikuar raportin e hulumtimit Gratë në Mediat e shkruara 2014-2015

<http://www.koha.net/arberi/4388/mustafa-rol-i-gruas-vendimtar-per-nje-kosove-prosperuese/>
<http://indeksonline.net/old/lajmet/mustafa-rol-i-gruas-vendimtar-per-nje-kosove-prosperuese-66595/>
<http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/grate-vazhdojne-te-mos-jene-te-perfshira-ne-vendimmarrje/>
<http://lajmi.net/mustafa-rol-i-gruas-vendimtar-per-nje-kosove-prosperuese/>
http://www.kryeministri-ks.net/index.php/2009/03/repository/images/common/docs/proc/repository/docs/Strategjia_Shqip.pdf?page=1,9,6630
<http://www.koha.net/zgjedhjet-lokale-2017/45940/gusia-mediat-te-perkrahin-grate-kandidate>
<https://telegrafi.com/gusia-mediat-ti-perkrahin-grate-ne-zgjedhjet-lokal/>
<https://m.facebook.com/BotaSotOnline/photos/a.153257978057026.29158.140995115949979/1438937789489032/?type3>
<http://tesheshi.com/agjencia-per-barazi-gjinore-media-te-perkrahin-grate-ne-zgjedhjet-lokale/>
https://www.google.com/amp/s/infoglobi.com/gusia-fion-mediat-grate-kandidate-te-prezentohen-denjesisht/%3famp_markup=1
<http://www.kosovapress.com/sq/mobile/lajme/gusia-mediat-te-perkrahin-grate-kandidate-131404/>
<http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=201488>

Linku i hulumtimit "Gratë në mediat e shkruara:

<https://abgj.rksgov.net/Portals/0/ABGJ%20HULUMTIMIGrat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruara.pdf>

25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit

Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit, me rastin e shënimit të 25 Nëntorit – Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj Gruas, ka ndërmarrë iniciativën për ndriçimin e Ndërtesës së Qeverisë me ngjyrë portokalle, dhe simbolin e kordeles së bardhë. Ky akt simbolik simbolizon përkushtimin e burrave dhe djemve kosovarë për të i'u bashkëngjiturë iniciativës botërore për eliminimin e fenomenit negativ të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Po ashtu është realizuar edhe një videoklip sensibilizues për mbrojtje nga dhuna në familje i cili është transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës, si dhe realizimi i disa fletoreve me moton “Jo të gjitha plagët janë të dukshme” ku në brendësi të fletores janë shënuar të dhëna rreth mekanizmave mbrojtës për rastet e dhunës në familje.

Aktivitete në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit janë realizuar me mbështetje të Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtarë – SIDA



Ndriçimi i ndërtesës Qeverisë Republikës së Kosovës në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit



Sekuenca nga videoklipi i realizuar në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit

“Jo të gjitha plagët janë të dukshme”

Fushata promovuese /Ligji për Barazi Gjinore

Me qëllim të promovimit të Ligjit dhe obligimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së barabartë në jetën politike për Zgjedhjet Lokale të 11 qershorit, dhe qendrore të 22 tetorit 2017, është organizuar fushatë promovuese me billbordë me temën e dispozitës ligjore për përfaqësim 50%, janë publikuar fletushka dhe është realizuar videoklipi televiziv “Përfaqësimi gjinorë 50%” i cili është duke u transmetuar në RTK. Po ashtu, ABGJ ka senzibilizuar opinionin mbi obligimin ligjorë për

përfaqësim 50% përmes komunikatave për media. Po ashtu është realizuar videoklipi për njoftimin e qytetarëve me procesin e verifikimit të të mbijetuarve/ave të dhunës seksuale gjatë luftës, i cili do të promovohet me 30 janar 2018.

Gjatë vitit 2017, ABGJ në total ka organizuar tre fushata vetëdijësuese për qytetarët e RKS, janë postuar 20 billbordë, 120 postera; 200 fletushka dhe 5 videoklipe televizive.



Sekuenca nga videoklipi për përfaqësimin e barabart gjinor në zgjedhjet lokale të 11 qershorit 2017



Sekuenca nga videoklipi për përfaqësimin e barabartë gjinor në zgjedhjen lokale 22 tetor 2017



Sekuenca nga videoklipi Verifikimi i Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës

Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe dokumenteve tjera me rëndësi të cilat promovojnë mundësitë e barabarta, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/02/2012 për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore, si dhe mandatis të saj, ABGJ ka përzgjedhur projektet të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin e ekonomike të tyre.

Të drejtë përfitimi për mbështetje financiare të projekteve kanë pasur personat fizik të cilët kryejnë aktivitete për zbatimin e normave të përgjithshëm të barazisë gjinore, dhe personat juridik të cilët janë aktiv në fushën e barazisë gjinore.

për vajzat dhe gratë që të krijojnë të ardhura për familjet e tyre.

ABGJ ka mbështetur projektin “Promovimi dhe ngritja e vetëdijës për gratë fermere në menaxhimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave të biodegradueshme” të OJQ Shoqata Afarsiste e Gruas “Shera”. Qëllimi i projektit ishte mbrojtja e mjedisit duke ulur efektet e dukshme të ndotjes dhe vetëdijësimin e grave fermere rreth menaxhimit të mbeturinave. Me këtë rast ABGJ ka mundësuar blerjen e 32 komposterëve për gratë fermere, ku përmes tyre do të përpunohen mbeturinat, si dhe ka mbështetur realizimin e një spoti televiziv informues rreth komposterave.



Gjithsej janë përzgjedhur gjashtëmbëdhjet projekte që i kanë plotësuar kushtet dhe specifikat e parapara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2012.

ABGJ ka përkrahur projektin “Paisje përpunimin e frutave të imëta”, ku është mundësuar blerja e makinave për mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e ambientit punues për përpunimin e frutave të imta. Kjo mbështetje do të ofroj stabilitet dhe zhvillim ekonomik të biznesit familjar, si dhe punësim

Me qëllim të rritjes së kontributit për industrinë e tekstilit dhe rrobave ABGJ ka financuar projektin “Zgjerimi i mundësive dhe kapaciteteve të përkrahjes së femrave në biznes, në prodhimin e veshjeve për femra” të OJQ-së ART –Fashion. ABGJ ka ndihmuar blerjen e një hekur për hekurosje me avull, dhe një tavolinë për prerjen e materialit. Me këtë rast janë vendosur linja moderne të makinerive për qepjen e tekstilit për të ruajtur qëndrueshmërinë e industrisë tekstile në rajonin

jugor të Kosovës.

ABGJ ka financuar projektin “Përfshirja e vajzave dhe grave nga zonat rurale në planifikimin e buxhetit Komunal-Politikat Publike”, të OJQ-së-KVR. Projekti ka pas qëllim që të rrisë pjesëmarrjen e vajzave dhe grave nga vendet rurale në komunën e prizrenit në procesin e planifikimit të politikave publike për mbështetje të sektorëve të ndryshëm me theks në sektorin e ekonomsisë.

ABGJ ka subvencionuar projektin “Gruaja për Gruan” të OJQ Jeta Buron, me qëllim të aftësimit profesional dhe socializimit të grave, iu është mundësuar blerja e tre makina qepëse. Po ashtu është mbajtur kursi për rrobaqepësi për gra dhe vajza. Kursin e kanë ndjekur rreth 30 pjesëmarrëse.



ABGJ në bazë të kriterëve për subvencionimin e projekteve ka përkrahur personin fizik duke i mundësuar blerjen e një lope qumështore me qëllim të mirëqenies familjare, duke ditur nevojat bazike ushqimore.

ABGJ ka përkrahur projektin “Blertaria Prodhimi/Përpunimi dhe marketingu i mjaltit” qëllimi i projektit ishte të investoj në rritjen e kapacitetit prodhues duke investuar në teknologji më të avancuar dhe për të krijuar kushte të favorshme për punë, duke mundësuar blerjen e centrifugave elektrike, kornizave, koshere për blete si dhe paketuese për mjaltë.

ABGJ ka mbështetur projektin “Vetë-Tregimet” të OJQ Byroja e vajzave Global Girl Media Kosova, me këtë rast është realizuar një dokumentar me grat dhe vajza të komunave të ndryshme të Kosovës, lidhur me tregimet e tyre sa i përket dhunës në familje, dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe fuqizimin ekonomik të tyre.

Duke ditur nevojat e grave për vetëpunësim, si dhe duke ofruar mbështetje për grate e veja, ABGJ ka subvencionuar projektin “Investim për ujitjen e plantacionit të mjedres”, ku u është mundësuar blerja e paisjeve të sistemit të ujitjes pikë, pike dhe blerja e dy pompave të ujit.

ABGJ ka mbështetur projektin “Hapja e dyqanit për punimet tradicionale-Antoneta”, me blerjen e dy makinave për qepje, material për punë dore dhe një makinë industriale.

Me qëllim të fuqizimit ekonomik të grave ABGJ ka bërë subvencionimin e projektit “Kultivimi ekologjik i perimeve në serë”, duke mundësuar blerjen e materialit shpenzues për ndërtimin dhe funksionimin e serës.

ABGJ ka përkrahur projektin “Fuqizimi ekonomik”, përmes këtij projekti është mundësuar blerja e një lope me qëllim të mbajtjes së familjes.

ABGJ ka financuar projektin “Rritja e numrit të bletëve”, me qëllim të zgjerimit të numrit të bletëve, dhe rritjes së të ardhurave familjare. ABGJ ka ndihmuar në blerjen e 15 copë koshereve, 15 copë shoqëri bletësh si dhe material shpenzues për mirëmbajtjen e bletëve.

ABGJ ka mbështetur projektin “Së bashku kundër dhunës në familje”, ku është bërë shtypja e 150 copë broshurave. Qëllimi i projektit ishte ngritja e vetëdijës tek grate e zonave rurale, lidhur me raportimin e rasteve të dhunës në familje.

Me qëllim të ngritjes së të ardhurave familjare, ABGJ ka mbështetur projektin “Ndihmë grave mbajtëse të familjes” të OJQ-së Keshilli rinor i Rahovecit”. Gjatë kësaj periudhe janë blerë tri maquina qepëse.

ABGJ ka subvencionuar projektin “Ngritja e kapaciteteve prodhuese”. Qëllimi i këtij projekti ka qenë blerja e paisjeve të nevojshme për të ngritur kapacitetet dhe rendimentet për përgatitjen e turshive tradicionale që cilësia të jetë e nivelit të duhur dhe konsumatorët të blejnë produktet vendore të sigurta. Ky investim i bërë do të ofrojë stabilitet dhe zhvillim ekonomik, punësim të grave dhe vajzave të reja që dëshirojnë të merren me aktivitete bujqësore të krijojnë të ardhura për familjen e tyre.

Komunikatë për Media - Me rastin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11-të qershorit 2017

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) e Republikës së Kosovës, ju përkujton subjekteve politike, pjesëmarrës në fushatën elektorale për zgjedhje të parakohshme parlamentare të 11-të qershorit 2017, respektimin dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës neni 6-të, pika (8-të) për përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativ me përfaqësim 50 përqind për secilën gjini.

Agjencia ju përkujton subjekteve politike se një përfaqësim i barabartë gjinor në vendim-marrjen politike e legjislativ të vendit është reflektim dhe zbatim i drejtëpërdrejtë si dhe jetëson Kushtetutën e Kosovës sipas së cilës “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Barazia gjinore, si vlerë themelore për ndërtimin e një shoqërie demokratike, duhet të përshkojë listat zgjedhore për përfaqësim të

barabartë, programet e partive me propozime konkrete për zhvillim të barabartë dhe cilësor mes gjinive, fuqizimin socio-ekonomik të grave, dhe nxitjen e pjesëmarrjes në votime të grave dhe burrave në Kosovë. Për të arritur barazinë e vërtetë gjinore dhe për të gëzuar të drejta të plota njerëzore, ndryshimet duhet të jenë të shpejta, vendimtare, të dukshme dhe gjithëpërfshirëse, prandaj duhet të kontribuojnë të gjithë që të shënojmë progresin që na detyron korniza ligjore e Kosovës dhe aspiratat dhe përprjekjet historike të gjithë brezave në Kosovë dhe obligimet ndaj gjithë qytetarëve dhe qytetareve të Kosovës.

Fuqizimi dhe përfaqësimi i gruas në sferën publike, politike dhe ekonomike është një shprehje e qartë mirënjohjeje dhe respekti për sakrificat shekullore të luftës së grave në Kosovë për liri, drejtësi dhe barazi. Përfshirja e grave në vendim-marrje është tipar i shoqërive demokratike, që synojnë harmoninë shoqërore, mbrojtjen e respektin e dinjitetit të individit dhe konsensualitetin në krijimin e agjendës zhvillimore të vendit.

Agjencia për Barazi Gjinore ju

përkujton subjekteve politike që gjatë fushatës elektorale në gjuhën e përdorur në takime me elektoratin, programet dhe premtimet elektorale, materialet promovuese të subjekteve politike të shmangin gjuhën seksiste, të dhunshme, dhe stereotipet gjinore.

Subjektet politike duhet të anagazhohen plotësisht në sigurimin dhe përkrahjen financiare të kandidateve gra në mënyrë të barabartë sikurse dhe për kandidatët burra, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin Për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

Agjencia për Barazi Gjinore ju bën thirrje subjekteve politike të shmangin konfrontimet e dhunshme dhe dhunën fizike ndaj gjithë kandidatëve, qofshin këta burra dhe gra, si dhe ndaj simpatizantëve dhe elektoratit. Ndërtimi i një shoqërie me vlera demokratike dhe që punon për harmoninë shoqërore dhe i kontribuon paqes mund të arrihet vetëm përmes konsensusit, dialogut, respektit për diversitetin e mendimit, përaktësive ideologjike, gjinore, etnike e kulturore, respektit të të drejtave dhe lirive të individit.

Komunikatë për Media - Me rastin të Zgjedhjeve Lokale të 22-të tetorit 2017

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) e Republikës së Kosovës, ju përkujton subjekteve politike, pjesëmarrës në fushatën elektorale për Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit 2017, respektimin dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës neni 6-të, pika (8-të) për përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativë me përfaqësim 50-të përqind për secilën gjini.

Agjencia për ju përkujton subjekteve politike se një përfaqësim i barabartë gjinor në vendim-marrjen politike e legjislativë të vendit është reflektim dhe zbatim i drejtpërdrejtë si dhe jetëson Kushtetutën e Kosovës sipas së cilës “barazia gjinore është vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Agjencia për Barazi Gjinore me shqetësim vëren se nga 91 subjekte politike të regjistruara për Kryetarë komunash në Zgjedhjet Lokale 2017-të, vetëm katër kandidatë janë gra, ose 4.4 % e numrit total të kandidatëve të propozuar. Fatkeqësisht, edhe këtë raund zgjedhjesh lokale, Kosova do të dështojë të shënojë përparimin e dëshiruar për avancimin e grave në vendim-marrje, do të dështojë të përmbushë obligimin ligjor dhe Kushtetues në përmbushjen e agjendës për barazi gjinore në Kosovë.

Zgjedhjet lokale të vitit 2013-

të rezultuan në zgjedhjen e një kryetareje komune. Me këto arritje dhe rezultate nga zgjedhjet e kaluara dhe me kandidaturat e propozuara aktualisht edhe Zgjedhjet Lokale të 2017-ës, avancimi i gruas në politikën lokale si udhëheqëse institucionesh qeverisëse përballet me një rrugëtim në vend numëro, e madje përkeqësues. Nuk mjafton të kemi një kuadër ligjor dhe institucional tejet të avancuar në mbështetje të barazisë gjinore të krahasueshëm e madje dhe më progresiv se shumë vende anëtare të Bashkimit Evropian, vendeve me demokraci të zhvilluar dhe stabilitet ekonomik. Nuk e kemi as luksin dhe as të drejtën e moszbatimeve të ligjeve që sigurojnë përfaqësim e pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave në Kosovë, për zhvillim të barabartë dhe cilësor mes gjinive, fuqizimin socio-ekonomik të barabartë, përfaqësim të barabartë dhe realizmin e aspiratave të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave në një shoqëri të drejtë dhe sa më harmonioze me tendencat zhvillimore.

Agjencia për Barazi Gjinore ju bën thirrje të gjithë subjekteve politike të regjistruara të respektojnë dhe katërcipërisht të zbatojnë detyrimin ligjor për 50 përqind përfaqësim të kandidatëve gra në listën e kandidatëve për kuvendet komunale. Tërheqim vëmendjen e subjekteve politike për rritje të dukshme të përfaqësimit të kandidatëve gra për kuvendet komunale posaçërisht në

komunat e Drenasit, Pejës, Skenderajt dhe Mitrovicës Veriore ku zgjedhjet vendore të 2013-tës, përfaqësimi i grave në kuvendet komunale respektive ishte nën 30-të përqind. Ju bëjmë thirrje subjekteve politike që në listat e kandidatëve për kuvendet komunale të sigurojnë përfaqësimin etnik, në mënyrë të veçantë të grave dhe vajzave nga komunitetet etnike rom, ashkali dhe egjiptas.

Agjencia për Barazi Gjinore ju kërkon të gjithë kandidatëve të propozuar për kryetarë komunash dhe kandidatëve për këshilla komunale që në programet dhe premtimet e tyre elektorale të reflektojnë barazisht nevojat e grave dhe burrave në Kosovë. Subjektet politike duhet të angazhohen plotësisht në sigurimin dhe përkrahjen financiare të kandidatëve gra në mënyrë të barabartë sikurse dhe për kandidatët burra, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin Për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

Agjencia për Barazi Gjinore kërkon nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve dhe subjekteve politike të sigurojnë pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave në komisionet e qendrave të votimit dhe trupat monitoruese zgjedhore.

Agjencia për Barazi Gjinore ju përkujton subjekteve politike që gjatë fushatës elektorale në gjuhën e përdorur në takime me elektoratin, programet dhe premtimet elektorale, materialet

Aktivitetet avokuese

promovuese të subjekteve politike të shmangin gjuhën seksiste, të dhunshme, dhe stereotipet gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore i bën thirrje Komisionit të Pavarur për Media për monitorim të vazhdueshëm të medias së shkruar dhe elektronike dhe përdorimin e sanksioneve që ju njeh korniza ligjore për përfaqësim dhe prezantim të barabartë të kandidatëve dhe pa diskriminim dhe denigrimin gjinor.

Apelojmë te mediat e Kosovës, publike dhe private, punonjësve të medias, shoqatave dhe unioneve të gazetarëve për një prezantim objektiv, adekuat, cilësor pa diskriminim dhe larg stereotipeve gjinore të të gjithë kandidatëve.

Agjencia për Barazi Gjinore ju kërkon subjekteve politike të shmangin konfrontimet e dhunshme dhe dhunën fizike ndaj gjithë kandidatëve, qofshin këta burra dhe gra, si dhe ndaj simpatizantëve dhe elektoratit, dhe të punojnë për të mos patur përsëritje të ngjarjeve të shëmtuara të zgjedhjeve të qershorit që lame pas. Ndërtimi i një shoqërie me vlera demokratike dhe që punon për harmoninë shoqërore dhe i kontribuon paqes, mund të arrihet vetëm përmes konsensusit, dialogut, respektit për diversitetin e mendimit, përkatësive ideologjike, gjinore, etnike e kulturore, respektit të të drejtave dhe lirive të individit.

Komunikatë për Media ABGJ MAPL - Komunikatë për Media me rastin e konstituimit të organeve të Qeverisjes lokale

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) /Zyra e kryeministrit dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ju uron për përzgjedhjen Tuaj, me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve lokale (2017), në Republikën e Kosovës, duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese!

Duke shfrytëzuar rastin e fillimit të ushtrimit të mandatit tuaj, ABGJ dhe MAPL, ju përkujton mandatarëve që janë përgjegjës për funksionalizimin e organeve komunale, Kuvendit të Komunës, si organi më i lartë si dhe ekzekutivin e Komunës, që propozimet për kandidatët/et për zv. Kryetarë/e të Komunave, Kryesues/e dhe zëvendës/e Kryesues/e të Kuvendit të Komunës, Kryesues/e dhe zv. Kryesues/e të Komiteteve, plotësimit të ekzekutivit me drejtor/e, obligimin për të respektuar zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës neni 6-të, pikat 7 dhe 8-të për: "Përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej 50 % - përqind për secilën gjini, përfshirë këtu edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse".

Përfaqësim i barabartë gjinor në vendim-marrjen politike dhe ekzekutive Komunale është reflektim dhe zbatim i drejtpërdrejtë si dhe jetësim i Kushtetutës së Republikës së Kosovës sipas së cilës "Barazia gjinore është vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore".



AGJENCIA PËR BARAZI GJINORË / ZYRA E Kryeministrit
Agencia za Ravnopravnost Polova / Urad Premijera
Agency of Gender Equality / Office Of The Prime Minister

Nr. **013-1515**
Data: **18.12.2017**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
Zyra e Kryeministrit - Urad Premijera - Office of the Prime Minister
Agencia për Barazi Gjinore - Agencia za Polna Ravnopravnost - Agency for Gender Equality

Nr. Prot. **439/2017**
Prat. No.
Data: **18/12/2017**
Date: **Prishtine/Prishtina/Prishtina**

Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit
Agencia za Ravnopravnost Polova / Urad Premijera
Agency of Gender Equality / Office Of The Prime Minister

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarcvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Të nderuar/a

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) / Zyra e kryeministrit dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ju uron për zgjedhjen Tuaj, me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve lokale (2017), në Republikën e Kosovës, duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese!

Duke shfrytëzuar rastin e fillimit të ushtrimit të mandatit tuaj, ABGJ dhe MAPL, ju përkujton mandatarëve që janë përgjegjës për funksionalizimin e organeve komunale, Kuvendit të Komunës, si organi më i lartë si dhe ekzekutivin e Komunës, që propozimet për kandidatët/et për zv. Kryetarë/e të Komunave, Kryesues/e dhe zëvendës/e Kryesues/e të Kuvendit të Komunës, Kryesues/e dhe zv. Kryesues/c të Komiteteve, plotësimit të ekzekutivit me drejtor/e, obligimin për të respektuar zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës nën 6-të, pikat 7 dhe 8-të për : " Përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legislative, ekzekutive dhe gjyqësore, dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësimi minimal prej 50 % - përqind për secilën gjini, përfshirë këtu edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse".

Përfaqësimi i barabartë gjinor në vendim-marrjen politike dhe ekzekutive Komunale është reflektim dhe zbatim i drejtpërdrejtë si dhe jetësimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës sipas së cilës "Barazia gjinore është vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore".

Me respekt,

Edi Gusia
Kryeshefe Ekzekutive
Agjencia Për Barazi Gjinore
Zyra e Kryeministrit

Rozafa Ukimeraj
Sekretare e Përgjithshme
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

ABGJ ishte pjesëmarrëse në takimin e gjashtë të organizuar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore, Vilnius-Lituani

Përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës, me ftesë të Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) Vilnius-Lituani, marrin pjesë në takimin e gjashtëfish të Zyrtarëve nga Vendet e Zgjerimit të BE-së dhe Turqia. Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ) është instrument për projektin e ndihmës së para-anëtarësimit që përfshin vendet kandidate për në BE dhe kandidatët e mundshëm. Qëllimi i këtij takimi ishte që të gjithë pjesëmarrësit të marrin njohuri rreth aktiviteteve dhe zhvillimeve për çështjet gjinore për vendet pretendente për zgjerim të BE-së, në Institutin dhe drejtorin e Përgjithshme për Negocimet e Lagjes dhe Zgjerimit (DG NEAR) si dhe të kontribuojnë në planifikimin e bashkëpunimit të mëtejshëm.

Takimi ishte i ndarë në dy sesione, ku sesioni i parë kishte të bëjë me iniciativën e EIGE për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave administrative mbi dhunën e partnerëve intime në BE 28 dhe diskutimin mbi mënyrën e transpozimit të rezultateve në vendet e IPA-s. Deri në fund të vitit 2017, EIGE do të përfundojë një studim që vlerëson cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave administrative mbi dhunën e partnerëve intime (IPV) dhe përdhunimin e mbledhur nga policia dhe sektorët e drejtësisë në çdo shtet anëtar të BE. Qëllimi i kësaj iniciative është krijimi i një kuadri raportimi dhe monitorimi për të ndihmuar shtetet anëtare (dhe kushdo tjetër që miraton kornizën) për të siguruar të dhëna të rregullta dhe të krahasueshme dhe për të përmbushur kërkesat e monitorimit të instrumenteve ligjore ndërkombëtare, veçanërisht të drejtat e viktimave Direktivën dhe Konventën e Stambollit. Ndërsa sesioni i dytë kishte të bënte me prezantimet e secilit vend pjesëmarrës si dhe konsultime dypalëshe me ekspertët e EIGE për mjetet e tjera të interesit të EIGE për vendet e IPA-s.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin, përfaqësueset të Republikës së Kosovës, Shqipëri, Maqedonia, Mali i zi, Bosnia dhe Hercegovina, Serbia dhe Turqia.



Foto e realizuar nga takimi në Vilnius, Lituani

Zyrtarë të ABGJ-së ishin pjesë e diskutimit publik “Qasja në drejtësi - Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”

Përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore me ftesë të rektoratit të Universitetit publik në Pejë, morën pjesë në diskutimin publik “Qasja në drejtësi - Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”.

Nga ABGJ u prezantua Plani I Veprimit në Zbatim të Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”, gjegjësisht shtylla e tretë “Viktimat e dhunës seksuale, tortures dhe formave tjera të dhunës së lidhur me konflikt/luftë kanë qasje në mekanizmat funksional për mbrojtje, qasje në drejtësi, rehabilitimin dhe re-integrimin e tyre”. Gjithashtu u diskutua për të drejtat e kësaj kategorie të njohur me ligj rolin dhe rëndësinë e ABGJ në tërë këtë process, siç është përfshirja e kësaj kategorie në ligj, hartimi i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me këtë kategori. Po ashtu, të pranishmit u njoftuan me procesin e njohjes dhe verifikimit të kësaj kategorie mënyrën e aplikimit dhe mandatin e komisionit për njohje dhe verifikim.

Në këtë takim morën pjesë Rektori i UP, Prof. Dr. Fadil Millaku, Elvana Shala Ambasadore e vullnetit të mirë në OKB-së nga Kosova, si dhe Feride Rushiti - Drejtore e OJQ-së KRCT.

Pjesëmarrje në Konferencën e Indeksit të Barazisë Gjinore, Bruksel

Përfaqësuesit e ABGJ-së morën pjesë në Konferencën e organizuar nga Instituti European për Barazi Gjinore (EIGE), i cili ka nxjerrë botimin e tretë të Indeksit të Barazisë Gjinore për BE, konferenca u mbajtë në Bruksel.

Konferenca ofrojë një forum për rreth 300 vendimmarrës dhe praktikues që u diskutua për gjetjet e Indeksit të Barazisë Gjinore 2017. Indeksi i ardhshëm i barazisë gjinore siguron një fushë më të gjerë për të kuptuar trendët dhe progresin në barazinë gjinore në BE. Domeni i tij satelitor i pabarazive ndërthurësh zbulon disa nga pabarazitë gjinore brenda disa grupeve të përzgjedhura të grave dhe burrave, bazuar në moshën, paftësinë, llojin e familjes, vendin e lindjes dhe arsimin. Me disponueshmërinë e indikatorëve të rinj, ky edicion ofron gjithashtu të dhëna të reja për sjelljen sociale dhe sjelljen shëndetësore.

<http://eurogender.eige.europa.eu/events/gender-equality-index-2017-release-council-eu#event>

<https://www.youtube.com/watch?v=H2ILmsXt4uQ>



Përfaqësues të ABGJ-së morën pjesë në konferencën regjionale "Matja e Barazisë Gjinore në Ballkanin Perëndimorë"



Me ftesë të shkollës Regjionale për Administratë Publike RESPA përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore, morën pjesë në Konferencën Regjionale "Matja e Barazisë Gjinore në Ballkanin Perëndimorë" në Danilovgrad, Mal të Zi.

Në cilësinë e panelistës Leonora Selmani Shefe e Divizionit për Legjilacion, ABGJ, prezantoi politikën dhe të arriturat e Republikës së Kosovës në Barazi Gjinore. Në takim morën pjesë edhe pjesëmarrës nga Republika e Kosovës, përfaqësues nga Avokati i Popullit, Kuvendi i Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Në këtë konferencë u diskutua edhe për Indeksin Gjinor dhe mundësitë e bashkëpunimit me shtetet rajonale dhe hapat që do të merren në të ardhmen nga RESPA.

Publikohet Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje si dhe Plan i Veprimit 2016 -2020



Foto e realizuar nga publikimi i Strategjisë KMDHF

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016-2020 u inicua bazuar në prioritetet e Qeverisë së Kosovës dhe sidomos në Planin Vjetor të dokumenteve strategjike që autorizojnë përgaditjen e kësaj projekti Strategjike. Vlen të theksohet se hartimi i këtij dokumenti është paraparë edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) që është dokument i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Mbrojtja e jetesës me dinjitet dhe pa dhunë garantohen që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e vijnë më tej me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna

në Familje, ku konkretisht kërkohet që Qeveria të hartojë dhe të miratojë Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje. Në zbatim të Ligjit në vitin 2011, Qeveria e Kosovës përmes Agjencionit për Barazinë Gjinore hartoi dhe miratoi Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2011 – 2014, i cili pas përfundimit edhe u vlerësua.

Procesi i hartimit të kësaj strategjie ka qenë gjithëpërfshirës me pjesëmarrje të të gjitha institucioneve relevante që trajtojnë dukurinë negative të dhunës në familje, dhe dhunën ndaj grave, përfaqësueses të shoqërisë

civile, organizata partnere dhe ndërkombëtare.

Të pranishëm në këtë takim ishin: Ministria e Drejtësisë Dhurata Hoxha, Zëvendës ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Colleen Hyland, Koordinatori Nacional për mbrojtje nga dhuna në familje, Zëvendësministri, Munir Basha, si dhe Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia. Ndër objektivat kryesore të strategjisë janë: Parandalimi dhe vetëdijesimi, Mbrojtja dhe koordinimi, Legjislacioni, hetimi dhe procedimi dhe Rehabilitimi dhe riintegrimi.

ABGJ mori pjesë në konferencën “Qasja në drejtësi dhe reparacione për të mbijetuarat e dhunës seksuale të lidhura me konfliktin”



Agjencia për Barazi Gjinore mori pjesë në konferencën e organizuar nga Zyra e UN Women në Kosovë: “Qasja në drejtësi dhe reparacione për të mbijetuarat e dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin”. Kjo konferencë organizohet në shënim të 17 vjetorit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1325.

Gjatë kësaj konference Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së, Edi Gusia potencoi se, ne si institucione bartim përgjegjësinë tonë për vonesat në ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës sociale dhe pensioneve, mirëpo kjo çështje është vetëm faza fillestare e një procesi i cili duhet vënë në qendër të agjendës ndërshtetërore të dialogut. Reparacioni duhet parë si pjesë e dialogut ndërshtetërorë Kosovë – Serbi dhe njohjes së dhunës së ushtruar dhe drejtësisë së munguar, dhe kjo drejtësi duhet vendosur. Mospjesëmarrja e grave dhe mostrajtimi i çështjes së reparacionit për të mbijetuarat e dhunës seksuale si pjesë e dialogut ndërshtetërorë është pjesë e munguar e dialogut. Nëse çështja e reparacionit dhe vënies së drejtësisë për të mbijetuarat e dhunës seksuale nuk përfshihet në këtë agjendë, dhe nuk i përfshimë gratë në këtë

dialog rrezikojmë harmoninë civile Kosovë, pa të cilën nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme. Paqja ndërtohet me dialog, dhe viktimat kanë emër. Nuk ka faj pa fytire, nuk ka viktimizues pa emër, dhe drejtësia duhet vënë në vend. Kjo është formula që të mbijetuarat ti lëvizim nga viktima në vendimmarrëse të drejtësisë së munguar.

Nuk mund të ketë politika efikente në mungesë të përfshirjes në dialog, drejtësia është obligim dhe detyrim ndaj të ardhmes së vendit tonë. Roli i komunitetit ndërkombëtarë si influencues i këtij dialogu për të sjellë palët në tavolinë, është i domosdoshëm si fasilitues i diskutimit të çështjeve të cilat po u kaluan në heshtje nuk zgjidhen vetvetiu, dhe pa diskutimin e tyre, paqja do të jetë e brishtë dhe artificiale. Kërkimi i faljes dhe pranimi i përgjegjësisë për krimet e kryera ndaj të mbijetuarave është një nga pikat ku fillon e ardhmja jonë si qytetarë të Evropës demokratike ku paqja është proces i të mësuarit, dhe falje kërkohet për pa -drejtësitë e përjetuara”. Në konferencë morën pjesë Atifete Jahjaga, Ulrike Lunacek, Vlora Çitaku, përfaqësues të institucioneve të RKS dhe shoqërisë civile.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit, është angazhuar për promovimin dhe fuqizimin e grave dhe vajzave me qëllim të reflektimit të vlerave artistike në veprimtari të ndryshme kulturore e sportive.

Departamenti i Kulturës më konkretisht Divizioni i Promovimit ka aprovuar 188 projekte prej të cilave 121 projekte me bartës meshkuj dhe 67 projekte me bartëse femra. Për këtë kategori janë ndarë një shumë prej 345.473 euro. Numër të konsiderueshëm të projekteve me bartëse gra dhe vajza ka pas Divizioni i promovimit kulturor/industria kreative 29 gra dhe vajza në raport me 7 bartës të projekteve meshkuj. Sektori i Arteve Skenike/Teatrit, për projektet e përkrahura nga Konkursi për Promovim Kulturor 2017 ka mbështetur financiarisht 7 projekte me bartëse femra me një shumë 24.200 euro. Lista e Projekteve me bartëse femra të përkrahura nga Divizioni i Librit dhe Bibliotekës arrin shumë prej 7 mijë euro të cilën e ndanë 6 bartëse të projekteve. Ndërkaq nga 29 projekte të përkrahura sipas konkursit të Projekteve Kulturore për Sektorin e Takimeve Letrare, 2 sosh janë bartëse femra.

Sektori i arteve vizuale si pjesë e projekteve nga Konkursi i vitit 2017 ka mbështetur 14 projekte me bartëse femra, 11 projekte me bartës meshkuj dhe 11 projekte të përbashkëta femra/ meshkuj me një shumë të gjithëmbarshme 57.900 euro. Ndërkaq, në Galerinë Kombëtare të Kosovës gjatë vitit 2017 kanë marr pjesë në ekspozita: 26 artistë/meshkuj, dhe 24 artiste/femra.

Në fushën e arteve muzikore janë përkrahur 14 projekte me bartëse femra dhe 20 projekte me bartës meshkuj. Përfshirë këtu edhe një numër projektesh të përbashkëta për mbarëvajtjen e projekteve në këtë fushë janë ndarë 110 mijë euro.

Buxhet i veçantë për fuqizimin e femrës në Sport

Departamenti i Sportit për vitin 2017, një ndër politikat më prioritet ka hartuar politikën, Sporti për Femra. Ky Departament pas aprovimit final të kësaj politike në bazë të buxhetit të aprovuar për vitin 2017 ka nda një buxhet të veçantë për avancimin e femrave në sport, rreth 10% e totalit të kodit të subvencioneve. Departamenti i Sportit në kuadër të politikave programore të vitit 2017, krahas ndarjes së buxhetit të veçantë për femra më rreth 320.000.00 euro, ka dizajnuar programe dhe mundësi të përfitimeve edhe në të gjitha politikat programore të Departamentit të Sportit.

Në kuadër të Federatave të cilat janë të Licencuara në Departamentin e Sportit 29 Federata të sportit kanë aktivitete të rregullta të sportit femërorë Vitin që po e lemë pas nga Departamenti i Sportit janë mbuluar rreth 85 aktivitete të sportit femërorë duke filluar nga krijimi i Klubeve të reja, krijimi i ligave të grup-moshave të reja, krijimi i reprezentacioneve të kategorive të ndryshme, pjesëmarrja e klubeve të femrave në gara Ballkanike, Evropiane e Botërore.

Në kuadër të 85 projekteve të realizuara për vitin 2017, ky Departament ka mbështet klubet e Femrave-Reprezentacionet e femrave në sigurimin e pajisjeve sportive, Organizimin e kampionateve të rregullta të grupmoshave, fazat përgatitore para ngjarjeve sportive të karakterit ndërkombëtarë, pjesëmarrjen në kampionate, Ballkanike, Evropiane dhe Botërore. Kinematografisë MKRS gjatë vitit 2017 ka mbështetur 30 projekte për të cilat është ndarë një buxhet prej 121.270 euro. Nga këto për 9 projekte të realizuara me bartëse gra janë ndarë 65.270 euro ndërsa për 21 projekte me bartës meshkuj janë ndarë 56 mijë euro.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ka realizuar aktivitete të shumta gjatë periudhës 2017, mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka organizuar sesione informuese për dhunën e bazuar në gjini, gjegjësisht rolin dhe përgjegjësin e institucioneve arsimore në identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në baza gjinore. Qëllimi kryesor i sesioneve informuese është rritja e vetëdijës së institucioneve arsimore për dhunën në baza gjinore roli dhe përgjegjësia e tyre në trajtimin e këtyre rasteve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Famije dhe roli i edukatorëve për ta parandaluar këtë dukuri. Takimet u zhvilluan në Prishtinë, Podujevë, Obiliq, F.Kosovë, Drenas, Prizren, Suharet, Mamush, Dragash, Malishevë, Mitrovic, Skenderaj, Vushtri, Klinë, Istog, Pejë, Deqan, Junuk, Gjakovë. Po ashtu në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, dhe mbështetur nga OSBE, ka mbajtur seancë informative për barazinë gjinore dhe dhunën e bazuar në gjini. Seanca informative janë mbajtur në pesë regjione të Kosovës me nga një komunë dhe nga një SHFMU të përzgjedhur nga DKA. Pjesëmarrë në këtë takim ishin nga Drejtoret e Shkollës, Prinderit, Anëtarët e Këshillit drejtues në shkollë, pedagog, psikolog, mësime të lëndëve të ndryshme si dhe nxënësit e shkollave. Janë mbajtur takime me drejtoret e SHMU si dhe SHML me qëllim të monitorimit të programeve mesimore me kurrikulë të re dhe pa kurrikul, për Barazi Gjinore.

Edhe gjatë këtij viti janë mbajtur aktivitete mbi zbatimin e Rezolutës 1325 Gjatë Paqja dhe Siguria, ku është plotësuar pyetësori: Integrimi i perspektivës gjinore në shkollë, me nx. kl 6,7,8 dhe 9 si dhe janë ndarë dhurata stimuluese për këto shkollë sepse janë shpërbluar për esen dhe vizatimin më të mirë që ishte garë në tërë Kosovën lidhur me promovimin e Rezolutës 1325.

ZBGJ ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Vajzave me moton “Fuqia e vajzave (vajzave) adoleshente, me organizmin e tryezave në nënt shkollë të komunës së Skenderajt. MASHT është përkushtuar vazhdimisht në krijimin e mundësive të barabarta dhe tejkallimit e paragjykimëve të kësaj natyre, prandaj synon që në mënyrë sistematike të krijojë një barazpeshë edhe në aspektin gjinor sa i përket profesioneve.

Ndër aktivitete tjera vlen të theksohet se MASHT ka organizuar edhe një trajnim në Shqipëri me temë “Trajtimi i barazisë Gjinore në tekste të reja shkollë”, me përfqësues të hartimit të kurikulave dhe tekstet shkollë, drejtoret e shkollave, mesimdhënësit, përfaqësues të ABGJ si dhe OJQ.

Gjithashtu në këtë punëtori u prezantuan të gjeturat nga hulumtimet si: Auditimi i çështjeve gjinore në arsim, Identifikimi i çështjeve diskriminuese në tekstet e shkollave fillore, mesme të ulëta, dhe në tekstet e shkollave të mesme të larta, Roli i mediave në përfaqësimin e barazisë gjinore dhe rëndësia e tyre në edukim.

Në fund të punëtorisë dolën edhe disa rekomandime si:

1. MASHT gjatë hartimit të ligjit për tekste shkollë ta respektojë barazinë gjinore në tekste shkollë dhe largimin e stereotipëve gjinorë duke u bazuar në ligjin që siguron barazi gjinore (Nr.05/L-020) dhe Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi (Nr. 05/L-021)
2. MASHT të bashkëpunojë me grup autorësh dhe recenzentët e teksteve shkollë në mënyrë që të bëhet respektimi i drejtësisë, barazisë gjinore në tekste shkollë.
3. Barazia gjinore të jetë pjesë nderkurrikulare dhe modulare në programet shkollë, qoftë edhe nëpërmes aktiviteteve edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore, largimin e stereotipeve dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike
4. Duhet të kemi kujdes në fotografitë, ilustrimet, përmbajtjet që na paraqiten në tekstet shkollë, të ekuilibrohen fotografitë, ilustrimet në tekstet shkollë në aspektin gjinor, të largohen përmbajtjet ku paraqiten stereotipe dhe diskriminim. Çështjet që kanë të bëjnë me barazinë, drejtësinë gjinore të jenë pjesë e kurrikulave, dhe gjinia femërore të jetë më e pranishme në tekstet shkollë si dhe të rishikohen rolet reale të femrave dhe meshkujve në tekstet shkollë.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MASHT

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, ka raportuar për fillimin e procesit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, është bërë një analizë fillestare për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe është në proces e sipër, si dhe me rastin e aplikimit të komunave në projektet për investim kapitale është përfshirë kriteri për barazi gjinore.

Sa i përket përfaqësimit gjinor në MAPL është siç vijon: Stafi politik prej numrit të përgjithshëm prej 14 të angazhuar, nga ta 3 janë femra dhe 11 meshkuj. Punësim i shërbimit civil nga numri i përgjithshëm prej 130 të angazhuar, nga ta 70 janë meshkuj dhe 60 janë femra. Pozitat vendimmarrëse janë 2 femra dhe 6 meshkuj. Pozitat menaxheriale 8 femra dhe 8 meshkuj, (50% me 50%).

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsin – MAPL, ka organizuar tryezë me temën "Sfidat në përfaqësimin e barabartë gjinor në institucionet publike në nivel qendror dhe atë lokal", ku u prezantuan tema të ndryshme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore si: "Gratë e Suksesshme në Kosovë", "Një storie suksesi të Gruas Shqiptare në Botë", "Përparësitë e gruas në procedura të rekrutimit në MAPL", "Sfidat e grave në karrierë paragykimet, kuotat, buxheti gjinor" dhe "Buxheti gjinor në planet e punës së

institucioneve publike".

MAPL, si në vitet e paraprake edhe gjatë këtij viti ka realizuar projektin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në MAPL, për 3 ditë, 4 persona me qëllim të shënimit të ditës ndërkombëtare për mundësitë e barabarta për punësim për personat me aftësi të kufizuara. Sipas kërkesës janë punësuar edhe kësaj radhe nga shoqatat dy femra dhe dy mashkuj me qëllim të zbatimit të LBGJ.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MAPL

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë, ka organizuar tryeza të mbajtura me profesionistët shëndetësorë sic janë: tryeza për zbatimin e Procedurave Standarde Veprimit për viktimat e dhunës në familje dhe Udhërrefyesin e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore me përkrahje finaciare të OSBE. Tryezat janë mbajtur në: Pejë, Istog, Deqan, Klinë, Gjiilan, Prizren, Prishtinë dhe Gjakovë, Mitrovicë, ku 385 profesionistë shëndetësorë dhe infermjer janë informuar lidhur me PSV me tema: "Monitorimi i Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Udhërrefyesin mbi dhunën e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore. Identifikimi, trajtimi, referimi dhe ri integrimi viktimave të dhunës në familje"; Po ashtu janë shpërndarë edhe formular dhe regjistri për plotësim në rastin e trajtimit të viktimave të dhunës në familje. Janë bërë vizita monitoruese në shërbimet shëndetësore në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare ka adresuar çështjet si në vijim: Ofrimi i shërbimeve shëndetësore; Respektimi i barazisë gjinore dhe

trajtimi i rasteve të dhunës në familje. Mbledhja e statistikave për pozitat vendimmarrëse në kujdesin parësor, ku rezultojë se në pozitat vendim marrëse janë 288 femra dhe 393 meshkuj. Ndërsa për trajtimin e rastëve të dhunës janë referuar 191 raste në kujdesin parësor. Me rastin e shënimit të 16 Ditë Aktivizmit ishte mbajta e tryezës në Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Prishtinës me profesionistët shëndetësorë të kujdesit parësor. Tema: Monitorimi i Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Udhërrefyesin mbi dhunën e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore. Pjesëmarrës ishin 50 profesionist shëndetësor të lamive të ndryshme dhe infermjer. Po ashtu janë shpërndarë edhe formular dhe regjistrim për plotësim në rastin e trajtimit të viktimave të dhunës në familje



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MSH

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka monitoruar zyrat kadastrale për zbatimin e Udhëzimit Administrativ me Nr.04/2017 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve, i cili ka për qëllim që bashkëshortet të cilët e regjistrojnë pronën e përbashkët të lirohen nga taksa fillestare (nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2014 për tarifat e shërbimeve regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme) në zyrat kadastrale komunale.

Sipas të dhënave që posedon AKK, numri i përgjithshëm mbi të drejtën e pronës dhe posedimi i përbashkët i pronës: Deçan 1, Shtime 2, Istog 3, Vushtrri 4, Kamenicë 9, Skenderaj 16, Obiliq



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në AKK

19, Kaçanik 22, Fushë Kosovë 47, Lipjan 51, Mitrovicë 56, Prishtinë 66, Malishevë 79, Gllugovc 86, Pejë 118, Gjilan 243, Ferizaj 375, që në total janë gjithsejtë 1197 raste.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, bazuar në kompetencat që ka, me aktivitetet e zhvilluara gjatë



këtij viti ka qenë e përkushtuar për: Procedurat e hapura, transparente dhe inkurajuese gjatë rekrutimit; Kushte të barabarta të punës dhe jo diskriminuese; Ambient të punës të sigurt dhe pa ngacmime; Vetëdijesim i stafit për gjininë; Ngritje në pozitë grada në bazë të meritokracisë; Mundësi të njëjta për të aplikuar në pozita të ndryshme të punës; Procedura të hapura, transparente dhe inkurajuese gjatë procesit të avancimit; Pjesëmarrje të barabartë në procese të vendimmarrjes dhe menaxhimit.

Aktualisht në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) janë 36 femra civile ose 27. 69% ndërsa, në pozita udhëheqëse janë 9 femra ose 6.92%, në kudër të numrit të përgjithshëm të stafit civil në MFSK. Ndërsa, femra në uniformë në MFSK janë 4 apo 6.15% nga numri i përgjithshëm i stafit ushtarak në MFSK. Ushtaraket në FSK mbajnë edhe pozita të rëndësishme në nivel komandues si zëvendëskomandant, komandant kompanie, komandant togu, numri i oficerëve femra është 22 ose 6.21% në kuadër të numrit të përgjithshëm të oficerëve në MFSK/FSK. Ndërsa, femra të uni formuara në FSK sipas gradave janë: 1 kolonel, 3 femra janë nënkolonel, 4 major, 5 kapitene, 6 toger, 3 nëntoger, 2 rreshter major, 12 kapter, 8 rreshter, 36 tetar, si dhe 120 ushtarë.

Për të zbatuar Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit

të Kombeve të Bashkuara “Gratë, Paqja dhe Siguria”, janë hedhë hapa të rëndësishëm për koordinimin e aktiviteteve si dhe objektivave të përbashkëta në fushën e mbështetjes së gruas në sektorin e sigurisë. Në kudër të saj gjatë vitit 2017, janë mbajtur takime me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, IAP, PK, UN-WOMEN, DCAF, KIPRED dhe OJQ.

Gjatë vitit 2017, NJDNJ në bashkëpunim me Departamentin Ligjor ka mbajtur një cikël trajnimesh në të gjitha kazermat e FSK-së me temat: “Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të FSK” si dhe “Ngacmimi seksual sipas kornizës ligjore të Republikës së Kosovë”. Këto trajnime i kanë ndjekur 229 pjesëtarë aktiv të FSK-së meshkuj, femra, pjesëtarë nga komunitet jo shumicë. Gjithashtu, NJDNJ ka mbajtur trajnim për ekipet mobile për Fushatën e Rekrutimit të Kadetëve për vitin akademik 2017/18, me fokus gratë dhe vajzat. Po gjatë vitit 2017, me ndryshimin e Kodit të Mirësjelljes për Forcën e Sigurisë së Kosovës është plotësuar dhe definuar me Nenin 24 Ngacmimi seksual. Njësia për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me Zyrën për Çështje të Komuniteteve në MFSK, ka mbajtur takime vjetore me pjesëtarë e FSK-së nga radhët e komuniteteve jo shumicë në të gjitha njësitë e FSK. Takimet vjetore realizohen me qëllim të vlerësimit të gjendjes reale në zbatimin e të drejtave të komuniteteve, të arriturat, sfidat në rrugën e integritetit të qëndrueshëm, duke krijuar komunikim të drejtpërdrejtë dhe duke i adresuar të gjeturat eventuale. Në këto takime është prezantuar dokumenti - Strategjia e Integritetit të Komuniteteve Jo shumicë në MFSK/FSK 2017-2020.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Infrastrukturës, gjatë vitit 2017 ka zhvilluar aktivitet të cilat konsistojnë në ushtrimin dhe veprimtarinë konformë planit dhe strategjisë së paraparë për këtë vit, në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të parapara me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të shënimit të 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Ministria e Infrastrukturës, me iniciativën e zyrtarës



Aktiviteti I realizuar nga ZBGJ në MI



për barazi gjinore, organizova tryezë diskutimi ku I parnismem ishte edhe Ministri Lutfi Zharku. Rëndesi të veçant i është kushtuar po ashtu shenimit të 25 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj Gruas. Në kuadër të kësaj fushate, janë përgaditët gota me logon “Stop dhunës

ndaj gruas”, “Komuniko me fjalë e jo me dhunë” si dhe kordelja e bardh, për punëtorët e MI-së. Nga buxheti i Ministrisë së infrastrukturës të paguar për trajnime jashtë vendit morën pjesë 159 kolegë të MI, gjithsej meshkuj janë nga 223 morën pjesë 124 (55,60%), kurse 68 femra janë morën pjesë

35 femra (51,47%), për vitin 2017. Sa i përket kandidatëve të cilët kanë kaluar provimin e autoshtetësisë sipas gjinisë janë: meshkuj 15821, ndërsa femra 11226. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në MI është 291, nga të cilët 223 ose 76,63% janë meshkuj, kurse 68 ose 23,36% janë femra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, ka raportuar për Statistikat e shkallës së realizimit të Barazisë Gjinore në Qendrën e Studentëve për vitin 2017

Nr.total i të punësuarve	Meshkuj	Femra	Përqindja e femrave
232	159	73	25%

Femra në pozita udhëheqëse në Qendrën e Studentëve

Nr.total i punëtorve në vende udhëheqëse	Meshkuj në udhëheqje	Femra në udhëheqje
7	5	2-përqindja 28.5%

Nr,i studenteve në Qendrën e Studenteve

Nr.total i studenteve	Meshkuj	Femra	Përqindja
3567	1414	2153	62%

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Financave, ka realizu disa aktivitete sa i përketë barazisë gjinore në këtë ministri, ku janë shtypur postera dhe

fletpalosje, rreth vetedijesimit të femrave sa u përket të drejtave të tyre. Gjithashtu është shpërndar Ligji për Barazi Gjinore, Ligjin për Trashëgimi, Programin për

Barazi Gjinore, Ligjin për Dhunën në Familje dhe Rregulloren për detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtareve përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, MAP

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Administratës Publike, ka organizuar tryezën diskutimi ku është prezantuar Udhëzimi Administrativ Nr.03/2016 për përfitimet e Grave dhe të Burrave, me rastin e regjistrimit të pronës së paluajtshme të përbashkët falas, në emër të dy bashkëshortëve. Në këtë

tryezë, pjesëmarrës ishin zyrtarët për barazi gjinore nga ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe zyrtarët e ministrisë përkatëse. Prezantimin e U.A u prezantua nga Agjencia për Barazi Gjinore. Pjesëmarrësit u ndien të lirë për të zhvilluar debat lidhur me përparësitë që ofron udhëzimi për pronën, por edhe

për mundësitë e regjistrimit të saj, falas deri në muajin prill 2018. Të pranishmet, në këtë tryezë, përgëzuan MAP-in për këtë nismë, që sipas tyre ofron njohuri dhe mundësi, që prona e përbashkët e dy bashkëshortëve të regjistrohet në harmoni me këtë akt juridik. Përfitues të këtë takim ishin 43 persona prej tyre 40 femra e 3 meshkuj.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është fokusuar në mbajtjen e trajnimeve me fokus barazia agjinore. Gjatë viti 2017, ka mbajt trajnime me temë „Fuqizimi i grave përmes qasjes në të drejtat pronësore mbi tokën“, si dhe „Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor në MBPZHR“, ku kanë qenë të ftuar stafi i

MBPZHR. Po ashtu janë mbajt

gjashtë (6) sesione, me temën: Gruaja Rurale në Kosovë, “Ndjeshmëria dhe integrimi gjinor në sektorin e pylltarisë”, “Përfshirja e saj në aktivitetet rurale dhe pyjore”, në këtë takim moren pjesë zyrtarët e lartë të MBPZHR-se dhe atë Komunal. Trajnimet u mbajtën në Prishtinë, Podujevë, Gjilan dhe Dragash.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, gjatë vitit 2017, ka raportuar lidhur me pagesat direkte dhe grantet. Sa i përket Pagesave Direkte në vitin 2017 kanë përfituar 857 fermer te gjinisë femrore në shumën totale prej 808.339.00 Euro. Ndërsa numri i fermereve të gjinisë mashkullore qe kanë përfituar gjatë vitit 2017 është 43491 fermer ne shumën totale prej 25.601.937.33 Euro.

- **Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore.**

Sektori për pemë drufrutore: Numri i përfituesve gjithësejtë 55, prej tyre 42 meshkuj dhe 13 femra

Sektori për pemë manore mjedrra: Numri i përfituesve gjithësejtë 26, ku prej tyre 17 të gjinis mashkullore, ndërsa 9 të gjinis femrore.

Sektori i serrave -	78 përfitues, prej tyre 7 meshkuj dhe 71 femra
Sektori i depove-	12 përfitues, prej tyre 9 meshkuj dhe 3 femra
Sektori trashja e viçave-	32 përfitues, prej tyre 25 meshkuj dhe 7 femra
Sektori trashja e zogjeve-	12 përfitues, prej tyre 6 meshkuj dhe 6 femra
Sektori i derrave-	5 përfitues, prej tyre 5 meshkuj dhe 0 femra
Sektori i lopeve qumshstore-	31 përfitues, prej tyre 28 meshkuj dhe 3 femra
Sektori i lopeve qumeshtit dele dhe dhi-	12 përfitues, prej tyre 10 meshkuj dhe 2 femra
Sektori pikat grumbulluese te qumeshtit-	4 përfitues, prej tyre 4 meshkuj dhe 0 femra
Sektori i rrushit-	21 përfitues, prej tyre 20 meshkuj dhe 1 femer
Sektori i vezeve-	6 përfitues, prej tyre 3 meshkuj dhe 3 femra
Sektori i pemeve tjera manore-	27 përfitues, prej tyre 18 meshkuj dhe 9 femra

- **Diversifikimi I fermave dhe zhvillimi I bizneseve**

Sektori i bletarise -	48 përfitues, prej tyre 19 meshkuj dhe 29 femra
Sektori i grumbullimit perpunimit dhe promovimit I prodhimeve jodrusore te malit-	8 përfitues, prej tyre 7 meshkuj dhe 1 femer
Sektori i perpunimit dhe promovimit te prodhimeve bujqesore te kultivuara -	12 përfitues, prej tyre 5 meshkuj dhe 7 femra
Sektori i zhvillimit dhe promovimit te aktiviteve artizanale-	12 përfitues, prej tyre 4 meshkuj dhe 8 femra
Sektori i zhvillimit te turizmit rural-	11 përfitues, prej tyre 8 meshkuj dhe 3 femra

- **Investimet ne asetet fizike ne perpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqesore**

Sektori i perpunimit te pemeve dhe perimeve-	2 përfitues, prej tyre 2 meshkuj dhe 0 femra
Sektori i perpunimit te veres-	3 përfitues, prej tyre 3 meshkuj dhe 0 femra.

Numri total i përfituesve të ndarë në sektor është 417, prej tyre 175 femra, ndërsa 242 meshkuj

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të përmbushjes së obligimeve të dala nga Ligji për Mbrojtje nga dhuna në Familje, nr.03/L-182/, neni 27, si dhe në bashkëpunim me ABGJ dhe institucionet tjera relevante monitoron implementimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe gjithashtu monitoron implementimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjegjësisht Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes edhe gjatë këtij viti 2017 ka vazhduar subvencionimin e Organizatave Joqeveritare që në kuadër të tyre ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje në proces të mbrojtjes sociale dhe ri-integritit të tyre. Shuma monetare e subvencionimit për OJQ që trajtojnë raste e dhunës në familje është 150.000.00 euro

Me qellim të rritjes së kualitetit të shërbimeve për mbrojtje të viktimave në familje përveç shërbimeve sociale që ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale që kanë shtrirje në tërë Kosovën, MPMS/DPSF ka krijuar dhe vazhdon ta forcoj partneritetin me OJQ-te të cilat kanë në programet e tyre; strehimin, trajtimin, përkrahjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje.

MPMS/DPSF ka realizuar marrëveshje profesionale për mbrojtjen dhe strehimin e viktimave të dhunës në familje me gjashtë strehimore në nivel nacional të cilat janë;

- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Raba Voca-Strehimorja në Mitrovicë;
- Qendra për strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren;
- Qendra për Mirëqenien e Gruas në Pejë;
- Shtëpia e Sigurt në Gjakovë;
- Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve, strehimorja në Gjiçan;
- Shtëpia Ime në Ferizaj.

Në bazë të monitorimit të bërë në dosjet e rasteve të dërguara nga ana e Qendrave për Punë Sociale, dhe monitorimin e bazës së të dhënave për shërbime sociale dhe familjare si dhe raporteve statistikore të dërguara nga OJQ –strehimoret lidhur me rastet e trajtuara, rezultojnë se gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2017 janë trajtuar, strehuar dhe i janë ofruar shërbime sociale 383 rasteve viktimat të dhunës në familje. Prejt tyre 213 gra dhe 170 fëmijë, viktimat të dhunës në familje (81 djem dhe 89 vajza).

Në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale funksionon Strehimorja e përkohshme e sigurt, strehimore e cila strehon raste të trafikimit me nivel të mesëm dhe të lartë të rrezikshmërisë, si dhe viktimat të trafikimit në cilësinë e dëshmitarit.

Strehimorja e përkohshme e sigurt është strehimorja e vetme shtetërore e cila ofron shërbime strehimi dhe rehabilitimi për kategoritë e lartshënuara. Fillimisht duhet theksuar që Strehimorja për Strehimin e Viktimave të Trafikimit e cila gjendet në Lypjan, punon 24 (njëzet e katër) orë në pa ndërprerë dhe akomodon/strehon viktimat e trafikimit me rrezikshmëri të lartë dhe të mesëm të sigurisë, si dhe dëshmitare të mbrojtura në cilësinë e viktimës së trafikimit. Në bazë të Rregullores (MPMS) nr. 01/2016 për funksionimin dhe punën në strehimoren për mbrojtjen e dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në bazë të monitorimit të bërë në dosjet e rasteve të dërguara nga ana e qendrave për punë sociale, viktimat të trafikimit të mitur dhe të rritur, vendor dhe të huaj dhe në bazë të barazimit të rasteve me Drejtoratin për hetim të trafikimit me qenie njerëzore në Policinë e Kosovës dhe monitorimin e bazës së të dhënave për shërbime sociale dhe familjare dhe në bazë të raporteve të strehimores së përkohshme të sigurt rezultojnë se gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2017 janë trajtuar dhe i janë ofruar shërbime sociale:

Gjatë këtij viti, në strehimore janë strehuar gjithsej:

- 35 viktimat të trafikimit;
- 15 viktimat të moshës madhore;
- 20 të moshës së mitur;
- 28 viktimat vendore;
- 7 ndërkombëtare.

Nga të gjitha rastet e strehuara ishin të gjinisë femërore janë 33 raste, ndërsa të gjinisë mashkullore janë dy raste.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjegjësisht Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar me subvencionimin për organizatat joqeveritare që në kuadër të tyre ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit në proces të mbrojtjes dhe ri-integritit të tyre.

Sa i përket subvencionimit, konkretisht gjatë këtij viti (Janar-Dhjetor 2017) Organizata joqeveritare

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

vendore „Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalim të Trafikimit me Qenie Njerëzore” ka vazhduar partneritetin me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe MPMS për këtë vit shuma e subvencionuar është 25.000.00 euro.

Po ashtu një organizatë tjetër që është subvencionuar është OJQ „Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve” organizatë e cila strehon fëmijë të keqtrajtuar, të abuzuar dhe fëmijë viktimë të trafikimit me nivel të ulët të rrezikshmërisë. Kur jemi te kategoria viktimë të trafikimit fëmijë, kjo organizatë gjatë këtij viti përpos rasteve të kategorive tjera ka vazhduar me strehimin e dy

fëmijëve, raste të trafikimit me nivel të ulët të rrezikut, fëmijë që janë duke u ri-integruar me të gjitha shërbimet. Shuma e subvencionuar për këtë vit është 35,000.00 euro.

Në kuadër të monitorimit të bërë gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2016, Qendrat për Punë Sociale në gjithë Kosovën kanë trajtuar, menaxhuar dhe u kanë ofruar shërbime sociale dhe familjare 23 viktimave të krimeve seksuale fëmijë.

Nga 23 rastet e krimeve seksuale fëmijë gjatë vitit 2017 rezulton se: 19 raste janë viktimë të gjinisë femërore, 4 raste janë të gjinisë mashkullore.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë, gjatë periudhës vjetore Janar – Dhjetor 2017, ka punuar sipas detyrave të përcaktuara në këshillëdhënie dhe monitorim të çështjeve të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore sipas Ligjit për barazi gjinore. MTI aktualisht ka gjithsejtë 212 të punësuar. Të gjinisë femërore janë gjithsejtë 69 nëpunëse ose 34% ndërsa nga gjinia mashkullore janë 143 që përbejnë 67%. Është ngritur numri i femrave në punësim dhe në vendimmarrje:

Gjatë këtij viti ka pasur rritje të numrit të femrave nëpunëse. Nga njëmbëdhjetë konkurse të shpallura, janë punësuar në MTI gjashtë (6) femra, dy në pozitën zyrtare, tri në pozitën zyrtare të larta dhe një Udhëheqëse e divizionit. Është rritur edhe numri i femrave në pozitë udhëheqëse. Sekretarja e përgjithshme në MTI vazhdon të jetë femër. Prej gjithsejtë nëntë Departamenteve sa ka MTI, katër prej tyre udhëhiqen nga femrat. Në pozitën e Udhëheqëseve të Divizionit janë gjithsej pesë nëpunëse femra. Vitin që lam pas në MTI është përpiluar Raporti I Buxhetimit gjinor sipas modelit të Buxhetimit që është realizuar për vitin 2016 nga RRGK e Financuar nga USAID.

Shuma e buxhetit për Agjencinë, Departamentin për vitin 2017 është 3,753,934.00 euro Nga janari deri në shtator për të gjitha kategoritë janë shpenzuar 1,823,255.00 Euro

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në MTI është 212, prej tyre 143 janë meshkuj, ndërsa 69 prej tyre femra.

Numri i zyrtarëve në Departamentin e financave dhe shërbimeve të përgjithshme sipas nivelit të pagës të ndara në bazë gjinore, për vitin 2017 (janar-shtator).

Niveli i pagës	Numri i përgjithshëm i personelit në çdo nivel page	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
201- 400	12	8	3425814	4	13608	3439422
401-600	17	5	21627	12	47421	69048
600+	1	1	5733	0	0	5733
Gjithsej	30	14		16		

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Në sektorin e zonave ekonomike për vitin 2017 janë gjithsej nëntë (9) projekte kapitale, të cilat janë në fazën e implementimit.

Ndërsa për secilin projekt sa kanë përfituar burrat/ djemtë dhe sa gratë/ vajzat është sa vijon:

- Panairi “Gratë në Biznes 2017”, në panair kanë marrë pjesë 13 OJQ të grave dhe 15 biznese me pronar gratë.
- Projekti Internship Biznesi, është në proces të përzgjedhjes së kandidatëve dhe nuk ka informata sa janë përfitues vajzat dhe gratë e sa djemtë dhe burrat.
- Janë realizuar 5 sesione informuese me biznese për programin e Zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe një sesion i veçantë vetëm për gratë ndërmarrëse ku pjesëmarrëse kanë qen rreth 25 pronare të bizneseve dhe OJQ-ve.
- Janë realizuar 4 konferenca me biznese me pjesëmarrje sipas listave të nënshkruara: Prishtinë 163 djem/burra dhe 10 vajza/

gra, Prizren 80 djem/burra dhe 2 vajza/gra, Mitrovicë 50 djem/burra dhe 11 vajza/gra, Istog 81 djem/burra dhe 6 vajza/gra.

- Panairi i prodhimeve bimore, blegtorale dhe agroindustriale PRISHTINA 2017 pjesëmarrja e mbi 10 OJQ-ve në të cilat gratë janë pronare ose menaxhere të subjekteve me një pjesëmarrje të mbi 60 grave në këtë panair. Ndërsa kompani pjesëmarrëse në këtë panair ku pronar janë burra 70 biznes
- Panairi ndërkombëtar Prishtina 2017 subvencionim i kompanive, OJQ-ve me pronare gratë prodhuese të arti zanateve dhe prodhimeve tradicionale 5 shoqata dhe mbi 20 biznese ku gratë janë menaxhere dhe pronare të bizneseve. Biznese ku pronar janë burra 80 biznese vendore dhe mbi 20 ndërkombëtare
- Panairi ANUGA 2017 pjesëmarrja e shoqatës Gratë e Krushës e cila përfaqëson anëtarësinë e mbi 40 grave të kësaj shoqate. Ndërsa kompani pjesëmarrëse në këtë panair ku burra janë pronar 7 kompani.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim ka raportuar mbi të dhënat e përgjithshme për punëtorët në këtë ministri.

Numri i përgjithshëm i punëtorëve në MKK, në

baza gjinore dhe përfaqësimi i nacionaliteteve është sic vijon: shqipëtarë 47 persona, serb 60, turk 3, boshnjak, goran 2 ndërsa ashkali, egjiptas, rom dhe malazez nuk ka. Ndërsa sa i përket gjinisë prej tyre 72 janë meshkuj, ndërsa 33 femra.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna



Aktivitet i realizuar nga ZBGJ në MD

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Drejtësisë, në kuadër të mandatit dhe fushë veprimtarisë së sajë bazuar në nenin 248 të Ligjit NR. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ka vizituar Qendrat Korrektuese dhe Qendrat e Paraburgimit. Gjatë këtyre vizitave është përqendruar në monitorimin e respektimit e të drejtave të njeriut. Njësia për çdo vizite ka bërë raport të shoqëruar me te gjetura dhe rekomandime.

Në Qendrën Korrektuese në Lipjan vitin shkollor 2017/2018 në procesin mësimor kanë ndjekur dhjete (10) të mitur, ndërsa vitin e kanë përfunduar tetë (8) të mitur prej tyre një (1) femër e mitur.

Për të ju ofruar ambient miqësor, riedukimin dhe rehabilitim femrave (të burgosurave) janë ofruar një varg aktivitete kulturore, edukative dhe sportive brenda dhe jashtë QK Lipjan.

Janë mbajtur një (1) shfaqje teatralë, dy (2) Koncert me këngë dhe humor, aktivitete kulturore dhe sportive, ku kanë marrë pjesë të gjithë të miturit dhe femrat.

Gjatë vitit 2017 janë mbajtur trajnime - projekte për risocializimin e të dënuarave femra, nga OJQ “Rrjeti i Grave” me temën “Të drejtat e femrave në risocializim”,

trajnimi ka qenë në dy faza dhe është mbajtur një herë në muaj (ka zgjat dymbëdhjetë muaj), trajnimin e kanë ndjekur pesëmbëdhjetë (15) të dënuara.

Më OJQ “Rri –drejt është mbajtur trajnim me temën “Gruaja prapa Grilave”, në trajnim e kanë ndjekur nëntëmbëdhjetë (19) të dënuara, trajnim ka zgjate 06 muaj.

ZBGJ në bashkëpunim me Sektorin e Trajnimeve në SHKK ka organizuar trajnimi pesë ditor, për stafin korrektues dhe punëtorët social me temën „ instrumentet ndërkombëtare dhe ligjet vendore për trajtimin e të burgosurve”. Gjatë këtij trajnim njësia ka prezantuar pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut (Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Ligji për Barazi Gjinore). Ne trajnim kanë marrë pjesë njëzet (20) pjesëmarrës, prej tyre pesë (5) kanë qenë femra. Pas trajnimit pjesëmarrësit i janë nënshtruar testit dhe janë certifikuar.

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, njësia ka organizuar një tryezë me temën, „ Te drejtat e personave të privuar nga liria-grave”. Qëllimi i tryezës ka qenë trajtimi i të drejtave të grave pa paragjykitje dhe diskrimin.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Punëve të Brendshme ka raportuar lidhur me statistikat e të punësuarve në këtë ministri

Numri total i të punësuarve në MPB është 823, ku prej tyre 468 ose 57% janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 355 ose 43% janë femra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas ka prezantuar Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-20., konkretisht prezantimin e dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore, mekanizmat institucional, trajtimi i barabartë në marrëdhëniet e punës, diskriminimi në baza gjinore dhe sanksionet e cekura në ligj. Ndryshe MMPH ka filluar një projekt katër vjeçar, me mbështetjen e SIDA-s. Me këtë rast janë mbajtur disa takime në komuna të ndryshme të Kosovës, me zyrtarë mjedisor. Nga ky projekt, priten

dobi dhe benefite në ngritjen e kapaciteteve në sektorin e barazisë gjinore e me theks në arritjen e objektivave që rrjedhin nga strategjitë dhe legjislacionin për mjedisin në Kosovës, që janë në fushëveprimin e MMPH-se e ku direkt janë të kyçur edhe Departamenti i Mjedisit. Në bazë të planit të punës ZBGJ ka filluar analizën gjinore, ku janë mbajtur takime me drejtor të departamenteve dhe udhëheqës të divizioneve, si dhe janë mbajtur tri fokus grupe për të gjithë punëtorët e MMPH. Temat të cilat janë diskutuar kanë qenë vendimmarrja, menaxhimi i resurseve, diskriminimi etj.

Sa i përket strukturës organizative në MMPH është siç vijon

Struktura organizative në MMPH 2017	Nr. i përgjithshëm i të punësuarve	Nr. i femrave të punësuar	Nr. i meshkujve të punësuar	Pozita udhëheqëse e femrave	Pozita udhëheqëse meshkujve
MMPH	249	92	157	16	29

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Obiliqit, ka mbajtur takime të ndryshme në bazë të përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi, takim me gratë e lagjes së Romëve në Plemetin për përfshirjen e të gjitha femrave në organizimin e mësimin jo formal (Zhdukja e analfabetizmit tek gratë e këtyre komuniteteve). Realizimi i projektit „Angazhim i Përbashkët për të Drejtat e Grave në Pronë të Përbashkët“ projekt ky i cili është organizuar në bashkëpunim me OJQ Polis, ku si rezultat i këtij projekti është arritur që në këtë komunë, të bëhet regjistrimi pa pages deri në fund të vitit 2018 (në projekt janë përfshirë takime informuese me përfaqësues të komunave, debate, seminar etj.

Në shenimin e 8 Marsit është organizuar tryezë e rrumbullakët me temën „Femra dhe Rëndësia e Saj“, ku pjesëmarrës ishin grupi i grave asambleiste, drejtorit komunale, OJQ lokale. Në bashkëpunim me grupin e grave asambleiste është realizuar projekti „Lobo dhe Realizo“, ku gjatë gjithë vitit është lobu tek drejtori e bujqësisë për ndarjen e subvencioneve për grate, dhe ky lobim ka arritur suksese ku kanë përfituar një numër i konsiderueshëm i grave. Po ashtu në bashkëpunim



Aktiviteti i realizuar nga

ZBGJ në Komunën e Obiliqit

me grupin e grave është bërë vizitë në FSK-në qëllimi i takimit ka qenë bashkëpunim i ndërsjellë.

Me rastin e shënimit të 16 Ditëve të aktivizimit, është vendosur kordelja e bardhë për stafin e komunës, janë vendosur postera dhe është organizuar debat me temën “Nëse e respektoni gruan keni siguruar të ardhmen”.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit,

bazuar në planin e punës ka organizuar aktivitete të shumta me qëllim të avancimit të barazisë gjinore. Me qëllim të vetëdijësimit të shoqërisë për rrezikun nga kanceri i gjirit, dhe nxitjen e institucioneve përgjegjëse për krijimin e kushteve më të mira për zbulimin e hershëm të smundjes dhe përmisimin e kushteve të trajtimit në Kosovë ka organizuar fushatë në ecje “Një hapë kundër kancerit të gjirit me grate e Komunës së Drenasit”, ku moren pjesë Kryetari i Komunës së Drenasit zt. Ramiz Lladrovci, zyrtaret komunal, aktivistet e OJQ-ve etj. Ndërsa në kaudër të 16 Ditëve të Aktivizimit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Familje, është organizuar një tryezë diskutimi mbështetur nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Misioni i OSBE-së, në Mitrovicë. Po ashtu u vizituan institucione të ndryshme të Komunës, ku bënë shpërndarjen e Posterëve, të Fletëpalosjeve, kordelës së bardhë si në institucionin e Komunës në Administratë, në Gjykatën Komunale në Qendrën për punë Sociale, në Kopshtin Ardhëmeria, në Shtëpinë e Shendetit në Stacionin Policor të Drenasit si dhe në Institucionet Shkollore. Gjithësej janë publiku postera 100 copë, dhe Fletushka 400.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Drenasit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit, bazuar në planin e punës, sipas të cilit është paraparë realizimi i shumë objektivave që synojnë Promovimin dhe integrimin e perspektives gjinore në politikat komunale dhe gjitha sferat e jetës shoqërore. Në këtë periudhë rëndësi të veçant ka pasur rritja e numrit të përfaqësimit të femrave në nivele të ndryshme të udhëheqjes dhe vendimarrjes si dhe përfaqësimit në Administratën komunale. Nga këto përpjekje kemi një numër të konsiderueshëm të përfaqësimit në krahasim me vitet paraprake dhe prej 83 numri i grave është rritur në 138 në Administratën komunale. Ndërsa në fushën e Arsimit është rritur numri i Drejtoreshave në nëntë dhe Zv.drejtoreshave në pesë si dhe nënt sekretaresha në shkolla fillore dhe e mesme. Gjithashtu me OJQ ka organizuar tryeza për promovimin e Udhëzimit Administrativ mbi regjistrimin pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortvetë dhe ky udhezim është postuar edhe në web-faqen e Komunës. Po ashtu Komuna e Prizrenit, mbështet mirëvajtjen e Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve –viktima të dhunës me dhënjën në shfrytëzim të objektit komuna, ku është e vendosur Strehimorja si dhe mbështetjen me dru për ngrohje qendrore dhe ndihmë financiare prej 5000Euro. Komuna në vazhdimsi edhe këtë vit mbështet promovimin medial përmes botimit të Broshurës -gazetes “Gruaja në fokus “ të cilën në bashkëpunim me zyrtaren për Barazi gjinore e përgatit OJQ e grave “Shtjefan Gjeqovi “ në të cilën promovohen projektet dhe aktivitetet e OJQ-ve , e në veçanti të grave. Me mbështetjen e Komunës është realizuar ekspozita e punimeve të dorës së femrave dhe promovimin e artizanateve si dhe panairë të ndryshme për promovimin e produkteve vendore, ku shumë femra kanë ekspozuar prodhimet e veta.

Realizimi i aktiviteteve të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës në familje është bërë përmes Ligjeratës dhe Debatit të mbajtur me Asamblenë komunale, shpërndarjen e fletpalosjeve me mesazhe edukative .Prezent në ligjeratë kanë qenë 31 fëmijë të shkollave të ndryshme fillore të cilët përmes aktiviteteve vetanake kanë marrë përsipër të shpërndajnë informacionet dhe fletpalpsjet tek nxënësit e shkollave që i përfaqësojnë.

Gjatë planifikimit buxhetor të Komunës, OJQ e grave janë ftuar në takim të veçant të organizuar nga zyrtarja dhe drejtoria e financave ku janë ndëgjuar kërkesat dhe propozimet e grave me qëllim të përfshirjes së tyre në planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2018.Kërkesat e tyre kryesisht janë përqëndruar në hapjen e qerdheve publike, mbështetjen e OJQ-ve për aktivitete të tyre si dhe hapjen e një qendre për gra.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Prizrenit

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Hanit të Elezit, gjatë viti 2017 ka zhvilluar takime të ndryshme, duke filluar me bashkëpunimin e Drejtorisë Komunale për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorinë e Bujqësisë ku bashkarisht kanë punuar në hapjen dhe regjenerimin e vendeve të punës për gjinin femrore, gjithashtu lehtësimin e hapjes së biznesit duke hequr taksat komunale për katër vitet e para të regjistrimit të një biznesi në emër të gjinis femërore.

Gjatë këtij viti ka pasur aktivitete dhe bashkëpunime me OJQ- në mbajtjen e tryezave, shpërndarjen e fletëpalosjeve me

qëllim senzibilizimin e qytetarëve në zbatimin e ligjit për barazi gjinore e në focus kemi pasur regjistrimin e pronave në emër të dy bashkëshortëve, gjithashtu kemi shenuar 16 ditë aktivizëm kundër dhunës në familje ku kemi mbajtur 4 katër ligjerata me nxënës të shkollave fillore të mesme të ulët dhe të mesme të lartë.

Në fund të raportit vlenë të përmendim zgjedhjet e fundit, ku nga 15 këshilltarë komunal, 7 prej tyre janë zgjedhur të gjinisë femërore, gjithashtu në përbërjen e qeverisjes së re në Han të Elezit kemi edhe një drejtoresh më tepër të gjinisë femërore.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës, në bashkëpunim me Institucionet, Komunale si dhe Organizatat jo qeveritare që punojnë në fuqizimin e pozitës së gruas, ka organizuar punëtorë dy ditore me qëllim të përfaqësimit më të madhë të grave në Asamblet Komunale. Me rastin e shënimit të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, është mbajtur një tryezë ku janë prezantuar sfidat dhe roli i pozitës së gruas në shoqëri. Ndërsa në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, janë mbajtur takime me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, me qëllim të njoftimit për rendësin e kësaj date.



Broshura e realizuar nga ZBGJ në Komunën e Pejës

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prishtinës, në

bashkëpunim me Grupin e Grave Deputete të kuvendit Komunal si dhe me Aleancën e Gruas të Bashkësisë së Tiranës, kanë mbajtur takime të përbashkëta duke filluar me Këshillin Bashkiak të Tiranës, Anëtarët e Aleancës së Grave që përfaqësojnë të gjitha forcat politike si dhe nën Kryetaren e Bashkësisë znj. Brunilda Paskali. Gjatë takimit u shpallën aktivitete dhe iniciativat lokale për fuqizimin e gruas nga të dy palet, ku u theksua se në Bashkinë e Tiranës nga 61 këshilltar sa ka gjithsej, prej tyre 31 këshilltare ishin femra.

Edhe këtë vit Komuna e Prishtinës me rastin e shënimit të 8 Marsit ka ftuar në takim mësueset dhe mësuesit veterane të arsimit të moshës 80 vjeçar dhe ju është ndarë mirënjohje, si dhe me rastin e shënimit të Ditës së Infermierisë është mbajtur një takim me infermieret veteran. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë mbajtur takime me nx. e shkollave të Komunës së Prishtinës me temën “Ngacimet seksuale”, ku janë përfshirë nx. e klasave të IX si të viseve rurale ashtu edhe urbane. Në kuadër të aktiviteteve “Promovimi i të drejtave të grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në trashëgiminë pronësore”, janë mbajtur takime me gratë e reja që të njihen me të drejtat e tyre pronësore.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Prishtinës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës, konform përgjegjësi që ka shfrytëzon të gjithë mekanizmat e mundshëm për të krijuar mundësi për pjesëmarrje aktive të femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke u munduar të krijojë një klimë në të cilën atyre ju mundëson të japin kontributin e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Duke marrë parasysh që komuna e Mitrovicës ka ndarë një nënkod për çështjet gjinore që nga viti 2013, për vitin 2017 është ndarë shuma prej 13.511 €. ZBGJ në bashkëpunim me OJQ Amza dhe Lobin e Grave të Maqedonisë kanë organizuar tryezë të rrumbullaktët, mbi Rezolutën 1325 “Gratë, Paqja dhe

Siguria”, lidhur me implementimin e aktiviteteve që rrjedhin nga kjo rezolutë. Po ashtu në bashkëpunim me Asociacionin e Grave dhe Bizneseve në Mitrovicë, është realizu vizitë në Kooperativen Bujqësore “Krusha e Madhe”, si dhe janë vizituar Bizneset që udhëhiqen nga Gratë në Mitrovicë.

Ndërsa, me subvencione nga nënkodi për çështje gjinore janë përkrahur këto organizata lokale të Mitrovicës:

OJQ – PRAM-i
OJQ – “Opfakos”
OJQ – “Down Syndrome Kosova”
OJQ – “Handikos”
OJQ – “Zëri i Prindërve”
OJQ – “Shoqata e të Verbërve”
Shoqata e të shurdhërve
Klubi i Basketbollit me karroca
TREPCA MITROVICË



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Mitrovicës

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Zubin Potokut, gjatë vitit është fokusuar në integrimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke monitoruar rregullisht të dhënat statistikore për numrin e grave dhe burrave, punonjësit në institucione, pozita drejtuese, fëmijët në shkolla etj. Janë mbajtur disa punëtori për shëndetin riprodhues të grave në zonat rurale. Po ashtu ZBGJ ishte pjesëmarrëse në takime dhe trajnime të

ndryshme të organizuara nga organizata dhe agjenci ndërkombëtare: OSBE, USAID, UNDP, etj. Gjatë vitit 2017 janë mbajtur takime të rregullta javore me zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale në Zubin Potok dhe zyrtarë të SHPK-së lidhur me luftën kundër dhunës në familje. Në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore në Leposaviq, janë mbajtur organizime në kaudër të 16 Ditëve të Aktivizmit me temë “Mirëqenia fizike, psikologjike, shoqërore dhe shpirtërore e grave”.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vitisë, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për të Drejtat Pronësore ka shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas 8 Marsi, përmes aktivitetit me temën “Dashuri e Barabartë-Të drejta të barabarta”. Në këtë takim ishin prezent këshilltare komunale, përfaqësues të shoqatave të grave, punonjëse arsimore, grupe të grave të lokaliteteve të ndryshme. Kjo ngjarje kishte synim të theksojë rëndësinë e të drejtave pronësore për fuqizimin ekonomik të grave dhe të drejtën e vajzave për tu trajtuar barabart në trashëgimin pronësore. Po ashtu është mbajtur edhe tryezë informuese me nxënësit e shkollave të mesme të komunës së Vitisë, drejtimi juridik, me temë: E drejta pronësore si e drejtë kushtetuese dhe rëndësia e zbatimit të saj në Kosovë”, ku moren pjesë stafi I komunës, zyrtarë të lartë të Gjykatës Kushtetuese, gjykatës së Vitisë, noterisë etj.

Në kuadër të javës për të drejtat e viktimave të krimit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në Viti dhe Ekipin Veprues për Siguri në Bashkësi, është organizuar fushatë e vetëdijesimit për të drejtat e viktimave të krimit, e cila ka zgjatur nga 20 deri më 30 prill. Përveç takimeve të mbajtura me

grupe të interes janë shpërndarë edhe broshura informuese.

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Komunës së Vitisë, konkretisht Zyrtares për Barazi Gjinore, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Grupit Lokal të Veprimit “Vitja” dhe të shoqatës “Hortikultura” në sheshin e qytetit të Vitisë, është mbajtur panairi i produkteve tradicionale vendore me moton “Dita e produkteve bujqësore dhe artizanale të grave të Anamoravës”, ku u dha mundësia grave që të promovojnë produktet ushqimore dhe ato artizanale. Ky panair është mbështetur në kuadër të projektit që mbështetet nga MBPZHR.

Me rastin e muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, janë mbajtur aktivitetet në

nivel komune për ndërgjegjësimin kundër kësaj sëmundje. Me këtë rast është mbajtur një ligjëratë lidhur me këtë sëmundje si dhe në qendër të qytetit është mbajtur edhe një ecje vetëdijësuese me moton: “ZBULIMI I HERSHËM - MBIJETESË”.

Subvencionimi i 12 shoqatave të grave që merren me zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe artizanale, mbështetje kjo që rrit fuqizimin ekonomik të gruas.

Në muajin Nëntor, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës (sektori kundër dhunës në familje) dhe Ekipin Veprues për Siguri në Komunitet, janë mbajtur 20 ligjëratë me temë “dhuna në familje destabilizon marrëdhëniet familjare” me nxënësit e shkollave të komunës, ku kanë qenë afër 600nx.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Vitisë

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt, ka kryer detyrat dhe aktivitetet në fushën e Barazisë Gjinore në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, Plani i Veprimit në zbatim të Rezolutës 1325, Gratë Paqja dhe Siguria etj. Gjatë viti është bërë monitorimi i Shkollave Filllore rreth rasteve të braktisjes së shkollës duke diskutuar me drejtoret e shkollave si dhe familjarët e nxënësve, ku bazuar në të dhënat e dalura është ulur numri i rasteve të braktisjes së shkollës, nga të gjitha shkollat filllore, ku ka qenë vetëm një rast të braktisjes së shkollës.

Drejtorja e Arsimit në Komunën e Skenderajt, ka ndarë 65 bursa për nxënësit e shkollave të mesme, prej tyre 24 kanë përfituar femrat. Sa i përket të punësimit, janë punësuar 8 Femra 4 në organet e Administratës dhe 4 Gra kryefamiljare janë punësuar nga IADK-ja si kuzhinierë në një shkollë. Gra që kanë përfituar pronë në emër të tyre janë 82, ndërsa 11 raste të regjistrimit të pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Ndryshe Kuvendi Komunal më dt. 09.03.2017 e ka miratuar Planin e Veprimit për Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Skenderajt 2017-2019. Është bërë certifikimi i 42 fermerëve,



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Skenderajt

njëra prej fermerëve e ka përfituar një pikë përpunuese, me qëllim që t'u ndihmohet grave fermere të interesuara për fushën e përpunimit të produkteve bujqësore, në bashkëpunim me IADK-en janë organizuar trajnime për aftësimin e grave për përpunimin e frutave të pemëve dhe perimeve. Ky projekt është realizuar nga IADK. Po ashtu është mbajtur takimi me temën "E drejta ime në Trashëgimi" është debatuar për të drejtën në pronë, me këtë rast është shfaqur filmi dokumentar "Lyp Hise Gjej Sherr", në takim morën pjesë Gra të moshave të ndryshme, ku u diskutua lidhur me problemet me të cilat ato ballafaqohen.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Junikut, gjatë vitit 2017, ka realizuar aktivitete të ndryshme sa i përket barazisë gjinore në këtë komunë. Në muajin Maj ka filluar implementimi i projektit "Fushata për ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat e pronësisë dhe të trashëgimisë së femrave në komunën e Junikut si dhe ligjërata me nxënësit dhe personelin arsimor të shkollave, ky projekt është përkrahur nga Kryetari i Komunës zotëri Agron Kuqi dhe është implementuar nga OJQ» JETA «Deçan. Ndërsa, ligjëratat në kuadër të projektit kanë vazhduar për 6 muaj në bashkëpunim me Zyrtarët e drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, drejtorin e Gjinnazit, Shoqatën e gruas Qershiza në Junik, gra, të rinjë, ligjëruese në projekt ishin Sanije Thaqi dhe Redona Gaxherri. Po ashtu në sallën e asamblesë Komunale është organizuar një workshop në kuadër të projektit të lartcekur ku është bërë prezantimi i hulumtimit lidhur me informatat të drejtat e femrave në pronë nga OJQ Jeta, në këtë



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Junikut

punëtori kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës z. Agron Kuqi, drejtorë dhe zyrtarë të qeverisë komunale në Junik, Deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, Gjyqtarë nga Gjykata themelore në Pejë, mësimdhënës, OJQ të grave nga Komuna e Deçanit dhe Junikut, Këshilli i veprimit Rinor Lokal në Junik, Zyrtarët për Barazi Gjinore të Komunës së Junikut dhe Deçanit.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit bazuar në Planin Nacional të Veprimeve për arritjen e Barazisë Gjinore por edhe në Planin lokal të Veprimeve për Barazi Gjinore ka realizuar aktivitete të ndryshme. Nisur nga fushata për shënimin e 8 Marsit-Dita Ndërkombëtare e Gruas, në bashkëpunim me një grup të grave të punësuar në insitucione të ndryshme por edhe familjareve të dëshmorve realizuan një vizitë në fabrikën e grave të Krushës në fshatin Krushë të Rahovecit. Janë realizuar disa aktivite që kanë pasur për qëllim promovimi e trashëgimise dhe pronës së gruas me gra, vajëza dhe me nxënës të shkollës së mesme në Komunën e Dragashit, kjo vizitë u mbështet nga USAID.

Po ashtu në bashkëpunim me Lobin për Barazi Gjinore janë realizuar disa takim dhe tryeza të ndryshme me qëllim të fuqizimit të gruas dhe lëvizjes për para të problematikës së barazisë gjinore dhe për funksionalizimi të çerdhës, si takimi me Kryetarin dhe me asamblesitet e Komunës si dhe me akter të ndryshmu komunal.

Për të promovuar një shoqëri pa dhunë në familje në baza gjinore dhe me të drejta të barabarta në bashkëpunim me Mekanizmat Komunal Kundër Dhunës në Familje dhe me tri vullnetare të Korpusit të Paqes që veprojnë në Komunën tonë, të mbështetur nga UNWMEN ,UNCEFI dhe Komuna, në muajin korrik është realizuar “Kampin për fëmijë “. Kampi është realizuar me nxënës të shkollës fillore “Fteah Sylejmai “në Dragash, gjegjesisht me klasën e 8 dhe 9, ku përmes lojës dhe aktiviteteve të ndryshme janë elaborur tema të ndryshme kundër diskriminimit me karakter avokues dhe lobues



Aktivitet i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Dragashit

pro barazisë gjinore.

Përveq takimeve të rregull që i mbajnë anëtarët e mekanizmit Komunal Kundër dhunë në familje për çdo dy muaj edhe

sivjet është mbajtur Fushata Globale 16Ditët e Aktivizmit, Fushatë Kundër Dhunës në familje me organizimin e një tryeze si dhe me shpërndarjen e broshurave sensibilizuese.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë, rëndësi të veçantë i është dhënë të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore si dhe të drejtave të komuniteteve. Me mbështetjen e kryetarit të komunës është realizuar ekskursioni me fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe në bashkëpunim me KVLR realizimi me sukses i konferencës për të drejtat e njeriut pikërisht në ditën e shpalljes së Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut ku ishin prezent edhe përfaqësuesit e Avokatit të popullit.

Në bashkëpunim me programin e USAID, është emëruar grupi punues, janë mbajtur takime rreth ngritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjimet buxhetore, pastaj ngritja e përqindjes së femrave në këto takime dhe të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në komunë. Janë mbajtur 15 takime, ku 30% prej tyre kanë qenë femrave. Po ashtu është organizuar tryezë kundër dhunës ndaj Gruas në sallën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, me pjesëmarrëse 45 gra.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës, merastin e 8 Marsit Dita Nderkombëtare e Gruas ka shpërblyer me mirënjohje tetë femra për koontributin që kanë dhënë ndër vite. Po ashtu gjatë vitit janë mbajtur takime për dhunën në familje, ku

gjithësejtë janë paraqitur 12 raste të dhunës. Me rekomandimin e ZBGJ në Komunën e Malishevës, komisioni për përzgjedhjen e bursave për student ka bërë vlerësimin e barabart, ku nga gjithësejtë 63 përfitues të bursave prej tyre 33 kanë qenë femra.

Po ashtu me rekomandimin e ZBGJ drejtuar DKA për pranimin kuadrit arsimor për të dy gjinitë në 37 vende të shpallura prej tyre 24 kanë qenë femra. Ndërsa, sa i përket avokimit në bashkëpunim me grupin e grave janë adresuar tri çështje të caktuara përgjatë 2017.

1. Sigurimin e mamografisë për komunën tonë me hapësirë të mjaftueshme dhe staf profesional (në procedurë).
2. Punësimi i grave kryefamiljare (janë punësuar katër gra kryefamiljare).
3. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në trajnime për aftësim profesional (janë certifikuar 16 gra dhe janë mbajtur trajnime në viset rurale për biznese të vogla, punësim sezonal, për kultivim dhe konservim të pemëve dhe perimeve).

Të dhënat statistikore në baza gjinore për vitin 2017

		NR.I PERGJ.	FEMRA	MESHKUJ	PERQINDJA
1	Komuna	194	29	165	14.9 %
2	Arsimi	1104	323	782	29.2 %
3	Shëndetësia	126	65	61	51.5 %



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Leposaviçit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Leposaviçit gjatë vitit 2017 është fokusuar në inkurajimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Ka qenë pjesëmarrëse në Bordet e komunës dhe në komisionin për politikë dhe financa, komitetin për siguri dhe prarandalimin e krimi, grupin punues për projekte etj. ZBGJ ka mbajtur takime të rregullta mujore me përfaqësues të OJQ-ve lokale, dhe përfaqësues të vetëqeverisjes lokale. ZBGJ ka asistuar realizimin e disa projekteve

të OJQ-ve lokale, ku përmes tyre u realizua edhe zbatimi i projekteve të saj. Po ashtu gjatë vitit ZBGJ ka qenë pjesëmarrëse në seminare dhe trajnime të ndryshme të organizuar nga organizatat dhe agjencitë e ndërkombëtare si OSBE, UNDP, HABITAT. Bashkëpunimi me Zyrtarët e Barazisë Gjinore në rajon me qëllim të shkëmbimit dhe përdorimit të dobishëm të përvojave dhe njohurive për avancimin e barazisë gjinore, në mënyrë që të përmirësohet përfaqësimi i barabartë i gjinisë në komunë.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Ranillukës, gjatë periudhës 2017 ka organizuar aktivitete sa i përket avancimit të barazisë gjinore. Për nder të festës së shkollës “Stevi Sava” ZBGJ në bashkëpunim me grupin joformal të Grave realizuan një fushatë për ndarjen e dhuratave për nxënësit e shkollave fillore në klasën e IV dhe fëmijët e kopshteve. Dhuratat janë ndarë në shkollën fillore “Veljko Dugoshheviq”, Ranilluk dhe në “Trajko Peric” në Velikom Rapotova si dhe fëmijës nga kopshti “May bee”. Me iniciativën e ZBGJ ne kuadër të 8 Marsit, Dita Ndërkombëtare e Gruas u ndan 60 dhurata për gratë e komunës së Ranillukës.

Me ndihmën e projektit CARE/RESI u mbajt trajnim njëditor për fermerët gra nga komuna e Ranillukës. Trajnimi synonte t’u mundësonte grave të përfshihen në zhvillimin e bujqësisë, të merrnin njohuri në plotësimin e formave të propozimit të projektit dhe strukturimin e ideve të tyre. Po ashtu nën organizimin e ZBGJ dhe Grupit joformal të Grave pëdisa ditë radhazi qëndruan në Ohër, ku gjatë kësaj periudhe u mbajt trajnim me temë: “Të drejtat pronësore të grave”. Trajnimi u mbështet nga OJQ -CDKD- Qendër për depolitizimin e shoqërisë kosovare. Gratë ishin në gjendje të dëgjonin për të drejtat e grave në fushën e trashëgimisë dhe rreth kornizës ligjore që lidhet me drejtën pronësore.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Ranillukës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit, duke u bazuar në plan-programin për vitin 2017, ka ndërmarr aktivitete të ndryshme me qëllim të ngritjes së guras në ekonomi dhe teknologji informative me organizimin e tryezave të rrumbullakëta, debate ku të gjitha këto janë mbajt në bashkëpunim me OSBE dhe me OJQ lokale për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore. Ndërkaq këshilli Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe ZBGJ kanë hapur fushatën sensibilizuese me paraqitje e spotit dhe kordeleve me moton “Ndal Dhunën në Familje dhe Jeto me dinjitet”. Aktivitetet

janë mbajtur edhe në viset rurale dhe urbane, po ashtu janë mbajt edhe me nxënësit e klasave të nënta me qëllim të informimit rreth kësaj dukurie.

Takimet kanë vazhduar në fshatin Janjevë me gratë e etnitetëve të ndryshme sa i përket dhunës në baza gjinore. Gjatë këtij takimi ligjërueses kanë qenë nga Qendra për Punë Sociale, ZBGJ, si dhe Zyra e Shërbimeve Sociale. Janë mbajtë aktivitetet me persona me aftësi të kufizuara, Handikos dhe OMPAK me ç’rast 20 persona të këtyre shoqatave kanë kryer aktivitete dy ditor me pagesë në administratën komunale në kudër të aktivitetit Tetori muaji i mundësive të barabarta.



Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Lipjanit

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna



Aktivitet i realizuar nga ZBGJ në Komunën e Kamenicës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Kamenicës, gjatë viti 2017 ka organizuar fushata sensibilizuese sa i përket të drejtave të njëriut, vizita institucioneve lokale etj. Në Ditën Ndërkombëtare kundër kancerit u shpërndan fletpalosje lidhur me informacionin sa i përket sensibilizimit të qytetarëve për të bërë kontrolla mjekësore të rregullta ngase “Zbulimi i herëshëm – shpëton jetë”. Me rastin e shënimit të fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore janë organizuar ligjerata nëpër shkolla fillore dhe të mesme të komunës me temë “Trafikimi me qenje

njerëzore, brengë që duhet të prekë edhe ty”. Këto ligjerata u mbajtën me nxënës të klasave IX, X, XI dhe XII, pran Sh.f. “Fan.S.Noli”, Sh.f. “Dëshmorët e Kombit”, Gjimnazit “Ismail Qemali” në Kamenicë dhe Shkollës së Mesme Mikse “Sejdi Kryeziu”, në Roganë. Qëllimi i fushatës ishte ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë dhe fuqizimi i ndërgjegjësimit mbi fenomenin në fjalë. Gjithashtu janë shpërndarë fletpalosje me informacione lidhur me parandalimin e kësaj dukurie.

Shënimi i 16 Ditëve të Aktivizmit, i është bërë vizitë stacionit

policor në Kamenicë, me qëllim të informimit sa i përket numrit të rasteve të dhunës ndaj gruas të raportuara në stacionin policor të kësaj komune. Gjithësejtë ishin raportuar 18 raste, prej tyre 7 meshkuj dhe 11 femra. Gjatë kësaj dite janë shpërndarë fletpalosje tek qytetarët me informacione sa i përket rëndësisë së kësaj dite. Fushata vazhdoi me vizita në disa shkolla, ku janë takuar me drejtorët me të cilët është diskutuar lidhur me këtë fushatë sensibilizuese dhe iu është kërkuar që të mbajnë orë mësimore me nxënës lidhur me Dhunën në Familje.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës, konform përgjegjësi që ka shfrytëzon të gjithë mekanizmat e mundshëm për të krijuar mundësi për pjesëmarrje aktive të femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke u munduar të krijoj një klimë në të cilën atyre ju mundëson të japin kontributin e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Në kuadër të muajit mars muaj i promovimit të drejtave të grave janë zhvilluar këto aktivitete.

Është mbajtur ekspozita nga grat që merren me Art, pikturë, letërsi, fotografi, grim, kreacione mode, punë dore me artizanate të ndryshe, punimin e qirinjve, ushqim etj;

Është mbajtur një forum diskutimi me këto tema: A jemi plotësisht të gatshëm si shoqëri të përshtatemi me gra të suksesshme? Cilat janë pengesat që e rendojnë zhvillimin artistik të gruas, por që nuk është një çështje e vetëbesimit?

Organizimi i Fushatës një mujore mbi edukimin shëndetësor – riprodhues të grave, nëpër të gjitha qendrat e Mjekësisë Familjare. Me qëllim të vetëdijesimit të grave për rendësinë e vizitave dhe kontrollit të tyre në parandalimin e sëmundjeve kancerogjene, si dhe arritja me e lartë e njohurive për evidetimin e sëmundjeve të gjirit dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse. Përfutuese direkte nga ky aktivitet kanë qenë 200 gra (10 qendra nga 20 gra).

Organizimi i panarit dy ditor me gratë e komunës së Gjakovës të zonave urbane dhe rurale, ku janë prezantuar punimet e grave si me ato me artizanate dhe prodhimin e produkteve ushqimore. Përfutuese e këtij panairi kanë qenë 20 gra në formë direkte dhe 20 tjera në formë indirekte. ZBGJ në bashkëpunim me shoqatën George Williams Youth Association ka organizuar tryezën e rrumbullakët në kuadër të aktiviteteve të muajit mars me moton "Muaji i promovimit të drejtave të grave". Në kuadër të tryezës është bërë lancimi i një video për të rinjet dhe të rejtat dhe barazinë gjinore me temën Barazia gjinore dhe rëndësia e implementimit të saj, në Komunën e Gjakovës.

Po ashtu janë mbajtur takime në bashkëpunim me shoqatën Medika Kosova, me temën "Përkrahja e grave kryefamiljare të dëmtuara nga lufta për t'ju qasur subvencioneve komunale në bujqësi" financuar nga Fondi i Grave të Kosovës (FGK), në kuadër të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK). Medika Kosova, gjatë realizimit të projektit ka zhvilluar 40 trajnime për gra lidhur me analizen e programit të subvencioneve, kriteret e aplikimit dhe qasjen



Foto e realizuar nga ZBGJ në Komunën e Gjakovës

në informata përmes internetit.

Në kuadër të fushatës globale 16 Ditët e Aktivizmit, mekanizmi koordinues kundër dhunës në familja ka zhvilluar takime me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek banoret e komunës së Gjakovës. Aktivitet janë realizuar përmes udhëheqjes së koordinatoreve të MKDHF me përkrahjen e anëtarëve të mekanizmit kundër dhunës në familje, (drejtorisë për administratë të përgjithshme, drejtorisë së arsimit me drejtorat e shkollave fillore të mesme të ulët dhe të larta, zyrës për komunitete, drejtorisë për shëndetësi, qendrës për punë sociale, gjykatës themelore, prokurorisë së shtetit, Policisë, mbrojtjesit të viktimave, spitalit rajonal "Isa Grezda", qendrës për ndërmjetësim, zyrës për ndihmë juridike falas. Mekanizmi është përkrahur edhe nga shoqatat/OJQ-te në realizimin e sukseshëm: "Shtëpia e sigurt", "Femrat Aktive të Gjakovës", "Shoqata për edukim dhe përkujdesjen e familjes", "Medica Kosova", "Caritas Kosova", Medika Kosova, Medika Gjakova, Rrjeti Qeliza, dhe TV Syri vision.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës, në bashkëpunim me organizatën e gruas "FLORI" ka organizuar panairi tre ditore me rastin e festave të marsit 6,7,8 mars, ku gratë kanë pasur raste të promovojnë produktet e tyre (pjesëmarrëse në panair kanë qenë 10 gra). Gjatë muajit shtator në bashkëpunim me organizatën POLIS "është organizuar tryezën për të drejtat e gruas në Pronë.

Ndërsa, në kuadër të fushatës të gjirit për gjatë muajit tetor me gratë e të gjitha komuniteteve, janë shpërndarë 20 postera dhe 100 fletushka.

Mandati i Agjencisë për Barazi Gjinore

Mandati, detyrat, dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Barazi Gjinore janë të percaktuara në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë.

Adresa:

Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit,

Sheshi Skënderbe kati VII, Prishtinë, 10000

Tel: +381 38 200 14 276

Email: info.abgj@ks-gov.net

Vizitoni Web faqen e ABGJ-së

<http://abgj.rks-gov.net>